



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 518 Akti

Nr. 360 Vendimi
Tiranë, më 25.3.2021

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Xhensila Pine	Kryesuese
Firdes Shuli	Relatore
Olsi Komici	Anëtar

asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Orianda Liçi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Gerrit Sprenger, në datat 23.3.2021 dhe 25.3.2021, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), kati 0 (*underground*), salla B, mori në shqyrtim në seancë dëgjimore publike çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Znj. Marsela Dervishi**, me detyrë gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier.

OBJEKTI: **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

BAZA LIGJORE: **Neni 179/b i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenet A, Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë;**

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, komisionere Firdes Shuli, mori në shqyrtim çdo provë dhe dokument të vënë në dispozicion nga organet kompetente ligjore, shpjegimet dhe provat shkresore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, përfundoi procesin e rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit, znj. Marsela Dervishi, e cila në seancë dëgjimore publike kërkoi konfirmimin në detyrë, si dhe bisedoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Znj. Marsela Dervishi është subjekt i rivlerësimit për shkak të funksionit të saj si gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier, bazuar në nenin 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim ligji nr. 84/2016).

2. Bazuar në pikën 2, të nenit 14, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe në rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin të Pavarur të Kualifikimit”, është zhvilluar shorti në datën 15.6.2020, në përfundim të të cilit rezultoi që subjekti i rivlerësimit, znj. Marsela Dervishi, do t’i nënshtrohej procesit të rivlerësimit nga trupi gjykues i përbërë nga komisionerët Xhensila Pine, Olsi Komici dhe Firdes Shuli. Relatore e çështjes u zgjodh me short komisionere Firdes Shuli.

3. Për këtë subjekt u administruan raportet e vlerësimit të hartuara nga: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI), sipas neneve 31 - 33, të ligjit nr. 84/2016; Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim DSIK), sipas neneve 34 - 39, të ligjit nr. 84/2016; dhe Këshilli i Lartë Gjyqësor (në vijim KLGJ), sipas neneve 40 - 44, të ligjit nr. 84/2016.

4. Me shkresën nr. *** prot., datë 19.4.2018, protokolluar nga Komisioni me nr. *** prot., datë 25.6.2019, ILDKPKI-ja ka vënë në dispozicion aktin përfundimtar të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë së subjektit të rivlerësimit, znj. Marsela Dervishi.

5. Me shkresën nr. *** prot., datë 31.10.2017, protokolluar nga Komisioni me nr. *** prot., datë 11.12.2020, DSIK-ja vuri në dispozicion raportin mbi kontrollin e figurës për subjektin e rivlerësimit, znj. Marsela Dervishi, i deklasifikuar plotësisht me vendim nr. ***, datë 9.12.2020, të KDZH-së.

6. Me shkresën nr. *** prot., datë 12.1.2021, protokolluar nga Komisioni me nr. *** prot., datë 29.1.2021, KLGJ-ja ka vënë në dispozicion raportin e analizimit të aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, znj. Marsela Dervishi.

7. Me vendimin nr. 1, datë 15.6.2020, trupi gjykues vendosi të fillojë hetimin administrativ, sipas nenit 45 të ligjit nr. 84/2016, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit të subjektit Marsela Dervishi, duke u bazuar në të tria kriteret e rivlerësimit, si dhe të caktojë kryesuesin e trupit gjykues, komisioneren Xhensila Pine. Të gjithë anëtarët deklaruan mosqenien në kushtet e konfliktit të interesit.

8. Në datën 22.7.2020 subjektit iu komunikua në rrugë elektronike përbërja e trupit gjykues, duke iu bërë me dije dhe e drejta për t’u shprehur në lidhje me konfliktin e interesit. Në datën

24.7.2020, nëpërmjet komunikimit elektronik, subjekti deklaroi mospasjen e konfliktit të interesit me ndonjë nga anëtarët e trupit gjykues.

9. Me vendimin nr. 2, datë 1.3.2021, trupi gjykues vendosi mbylljen e hetimit administrativ për subjektin e rivlerësimit, znj. Marsela Dervishi, dhe vendimmarrja në përfundim të procesit të rivlerësimit të bazohet në tria kriteret: vlerësimin e pasurisë, kontrollin e figurës dhe vlerësimin profesional, sipas parashikimit të pikës 2, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016.

10. Në datën 2.3.2021, përmes postës elektronike, trupi gjykues njoftoi subjektin e rivlerësimit mbi: (i) rezultatet e hetimit kryesisht; (ii) kalimin e barrës së provës, sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, për të provuar të kundërtën, jo më vonë se data 12.3.2021; si dhe (iii) njohjen me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016 dhe me nenet 45 - 47 dhe 35 - 40 të Kodit të Procedurave Administrative.

11. Në datën 11.3.2020 subjekti i rivlerësimit, me anë të postës elektronike, dërgoi shpjegimet e saj në përgjigje të rezultateve të hetimit administrativ kryesisht.

12. Pas shqyrtimit të shpjegimeve të vëna në dispozicion nga subjekti, me vendimin nr. 3, datë 17.3.2020, trupi gjykues vendosi kalimin në seancë dëgjimore, duke e njoftuar subjektin me anë të postës elektronike se seanca dëgjimore do të zhvillohej në datën 23.3.2021, ora 12:30, në Pallatin e Koncerteve, Tiranë, si dhe duke i dhënë të drejtën e përfaqësimit nëpërmjet një përfaqësuesi ligjor.

13. Në datën 23.3.2021 u zhvillua seanca dëgjimore, në të cilën subjekti kërkoi konfirmimin në detyrë.

II. FAKTET DHE PROVAT MBI TË CILAT ËSHTË MARRË VENDIMI

A. VLERËSIMI I PASURISË

A/1. Vlerësimi i pasurisë nga ILDKPKI-ja

Në zbatim të nenit 31/1 të ligjit nr. 84/2016 rezulton se subjekti i rivlerësimit, znj. Marsela Dervishi, ka dorëzuar pranë këtij institucioni deklaratën e pasurisë në datën 27.1.2017 (duke përfshirë personin e lidhur), pra, në periudhën kur ligji ka qenë në fuqi dhe brenda afatit 30-ditor nga hyrja e tij në fuqi. Gjithashtu, në referencë të nenit 32/2 të ligjit nr. 84/2016 dhe në zbatim të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarinimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar, si dhe ligjit nr. 9367, datë 10.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar, vërehet se subjekti i rivlerësimit, znj. Marsela Dervishi, është bërë subjekt deklarues në ILDKPKI në vitin 2012, me nr. indeksi *** dhe ka dorëzuar rregullisht deklaratat e interesave private në vijim.

ILDKPKI-ja ka dërguar aktin e përfundimit të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë, ku në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera par subjektin Marsela Dervishi, ka konstatuar se:

- *deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;*
- *ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- *nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- *nuk ka kryer deklarinim të rremë;*
- *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

A/2. Rivlerësimi i pasurisë nga Komisioni

Megjithëse sipas kreut IV të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e pasurisë së subjekteve të rivlerësimit, referuar vendimit nr. 2/2017, të Gjykatës Kushtetuese dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, realizoi një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi të kriterit pasuror për subjektin e rivlerësimit, znj. Marsela Dervishi, i cili nuk është bazuar dhe as është detyruar nga përfundimet e paraqitura nga ILDKPKI-ja.

Në përmbushje të funksioneve të tij kushtetuese, sipas pikës 1, të nenit 45, të ligjit nr. 84/2016, Komisioni ka hetuar të gjitha faktet dhe ka vlerësuar të gjitha rrethanat e nevojshme për procedurën e rivlerësimit në zbatim të nenit 179/b të Kushtetutës, duke kryer një proces të plotë hetimi administrativ për pasurinë e subjektit të rivlerësimit, znj. Marsela Dervishi, si dhe të personave të lidhur me të, sipas dispozitave ligjore të kreut VII të ligjit nr. 84/2016, bazuar në: (i) deklaratimet e subjektit në ILDKPKI; (ii) provat shkresore të administruara nga ky institucion dhe raporti i dorëzuar në Komision; (iii) çdo dokument ligjor që përbën mjet prove ligjor të kërkuar nga Komisioni gjatë procesit të rivlerësimit, sipas nenit 49 të ligjit nr. 84/2016; si dhe (iv) komunikimet me subjektin sipas nenit 46 të ligjit nr. 84/2016 dhe dispozitave përkatëse të Kodit të Procedurave Administrative.

Hetimi administrativ në lidhje me rivlerësimin e pasurisë, konsistoi në: (i) verifikimin e vërtetësisë së deklaratimeve në lidhje me gjendjen pasurore të subjektit dhe të personave të lidhur; (ii) verifikimin e burimeve të krijimit të të ardhurave dhe shpenzimeve, me qëllim evidentimin ose jo të mungesës së burimeve të mjaftueshme financiare për të justifikuar pasuritë; (iii) evidentimin ose jo të fshehjes së pasurive; (iv) evidentimin e deklaratimeve të rreme; si dhe (v) nëse subjekti ndodhet në situatën e konfliktit të interesit, me qëllim verifikimin e deklaratimeve të pamjaftueshme në lidhje me kriterin pasuror, sipas parashikimit të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, i cili i referohet nenit 33 të tij.

Pasuri të deklaruara nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën *Vetting*

1. Automjet tip “Volkswagen Golf 4”, viti i prodhimit 1999, blerë në datën 28.3.2012, sipas kontratës nr. ***, të lidhur para noteres E. H..

Burimi i krijimit: kursime personale të krijuara nga dhuratat e prindërve dhe të afërmeve, si dhe pagesa nga bursa e Shkollës së Magjistraturës. Vlera: 400.000 lekë. Pjesa takuese: 100 %.

Hetimi i Komisionit në lidhje me këtë pasuri

DPSHTRR-ja¹ konfirmoi deklarin e subjektit, duke informuar se znj. Marsela Dervishi ka të regjistruar automjetin tip “Volkswagen Golf”, me targa ***, i cili më parë ka pasur targën ***, me nr. shasie ***, blerë me kontratën nr. ***, datë 29.3.2012, nga shtetasi V. P.², në shumën 400.000 lekë, likuiduar jashtë zyrës noteriale.

Për sa i takon burimit të krijimit të pasurisë, në deklaratën para fillimit të detyrës të vitit 2012, subjekti ka deklaruar këtë automjet me burim krijimi “kursime personale”. Edhe në deklaratën *Vetting* subjekti ka deklaruar si burim krijimi “kursime personale”, duke specifikuar kursimet nga bursa e Shkollës së Magjistraturës, si dhe dhuratat e prindërve dhe të të afërmeve. Subjekti, pasi është pyetur nga Komisioni në lidhje me të ardhurat që kanë shërbyer si burim për kursimet personale, në përgjigje të pyetësorit nr. 2 ka deklaruar se automjeti është blerë mbi bazën e kursimeve të saj dhe familjes para fillimit të detyrës, dhe konkretisht: (i) shuma 200.000 lekë

¹ Shihni shkresën kthim përgjigje nr. *** prot., datë 14.12.2020, nga DPSHTRR-ja, në dosjen e Komisionit.

² Ky shtetas e kishte blerë automjetin në vitin 2008 në shumën 500.000 lekë, sipas kontratës së shitblerjes nr. ***, datë 10.7.2008.

i është transferuar prej nënës së saj, V. D., në llogarinë e saj në “Raiffeisen Bank”³; (ii) shuma simbolike prej 35.000 lekësh i është dhuruar me rastin e shpalljes fituese në konkursin e Shkollës së Magjistraturës; (iii) shuma e përfituar nga pagesat e bursës së Shkollës së Magjistraturës, në total 165.000 lekë për gjithë periudhën, vërtetuar nga Shkolla e Magjistraturës⁴ dhe konfirmuar nga lëvizjet e llogarisë së subjektit në “Raiffeisen Bank”⁵.

Pavarësisht këtyre sqarimeve, Komisioni ka verifikuar mundësinë e subjektit për të krijuar kursime personale me të ardhurat e saj vetëm nga pagesat e Shkollës së Magjistraturës për periudhën nga viti 2010 deri në momentin e blerjes së automjetit në datën 28.3.2012, pasqyruar në mënyrë të përmbledhur në tabelën si vijon, e cila rezulton me balancë pozitive.

Tabela nr. 1

Përshkrimi	Nëntor 2010 – 28.3.2012
Pasuri	400 674
Automjet “Volkswagen Golf 4”, ***/ ***, blerë më 28.3.2012	400 000
Shtesa/Pakësime, likuiditete	674
Të ardhura, dokumentuar	726 750
Të ardhura nga bursa e Shkollës së Magjistraturës	726 750
Shpenzime	284 944
Shpenzime jetese për një person	194 277
Shpenzime qiraje ⁶	90 667
Mundësia për kursime	41 132

Analiza financiare është kryer duke përdorur metodologjinë kumulative, pasi periudha e analizuar është para fillimit të detyrës dhe deklarimit të parë të pasurisë.

Në përfundim të hetimit administrativ nuk u evidentuan dyshime dhe problematika në lidhje me këtë pasuri, të cilën subjekti e ka përfituar në mënyrë të ligjshme si dhe ka pasur mjaftueshëm kursime personale me të ardhura të ligjshme për pagimin e çmimit në vlerën 400.000 lekë.

2. Llogari bankare depozitë me nr. ***, e hapur në datën 27.9.2013, në bankën “Societe Generale Albania”.

Burimi i krijimit: dhuratë nga gjyshërit, mbyllje depozite në emër të shtetasve H. D. dhe I. D. dhe çelje depozite në emër të shtetasës Marsela Dervishi. Vlera: 354.640 lekë. Pjesa takuese: 100 %.

Hetimi i Komisionit në lidhje me këtë llogari bankare

Banka “Societe Generale Albania” ka konfirmuar këtë llogari, si dhe gjendjen e saj sipas deklarimeve të subjektit⁷. Konkretisht, në datën 27.9.2013, në llogarinë bankare të subjektit është depozituar shuma 872.200 lekë, me përshkrimin “*paguar nga H. D. ose I. D.*”. Në të

³ Shihni shkresën nr. *** prot., datë 9.12.2020, të “Raiffeisen Bank”, administruar në dosjen e Komisionit.

⁴ Shihni shkresën nr. *** prot., datë 20.10.2016, në Aneksin ***, në dosjen e ILDKPKI-së.

⁵ Shihni shkresën nr. *** prot., datë 9.12.2020, të “Raiffeisen Bank”, administruar në dosjen e Komisionit.

⁶ Në pyetëtorin nr. *** subjekti ka deklaruar se gjatë studimeve në Shkollën e Magjistraturës ka banuar me qira në një apartament 1+1, në shumën 16.000 lekë/muaj, pranë Shkollës së Baletit, së bashku me dy miket e saj J. Gj. dhe L. S., me të cilat ka ndarë edhe vlerën e qirasë, pa lidhur kontratë me shkrim.

⁷ Shihni shkresën nr. *** prot., datë 2.12.2020, të bankës “Societe Generale Albania”, në dosjen e Komisionit.

njëjtën datë e gjithë shuma është investuar në një depozitë me afat 13-mujor nga subjekti i rivlerësimit.

Nga deklaratimet e subjektit konstatohet se: (i) në DPV-në e vitit 2013 është deklaruar: *Depozitë bankare. Mbyllje depozite në emër të shtetasve H. D. dhe I. D.. Çelje depozite në emër të znj. Marsela Dervishi. Vlera: 872.200 lekë*; (ii) në DPV-të e viteve 2015 dhe 2016 subjekti ka deklaruar pakësim të kësaj depozite, përkatësisht në shumat 250.000 lekë dhe 200.000 lekë.

Për sa i takon shumës 872.200 lekë, dhuruar nga shtetasit H. D. dhe I. D. në datën 27.9.2013, në përgjigjet e pyetësorit nr. *** subjekti ka dhënë sqarime më të hollësishme duke deklaruar se *kjo shumë ka qenë e depozituar pranë bankës "Societe Generale Albania" (sot OTP Bank) prej vitit 2005 dhe se i është dhuruar për shkak të afeksionit që kishin dy gjyshërit për mbesën e tyre të vetme. Burimi i kësaj shume janë kursimet familjare ndër vite (nga pensioni i pleqërisë, puna e tokës bujqësore, të ardhurat nga rritja e bagëtive, paga e prindërve etj.). Një pjese e kësaj shume ka qenë e depozituar në sistemin bankar që prej vitit 1999 (pranë Bankës së Kursimeve). Më pas, kjo shumë, së bashku me disa kursime të tjera, është depozituar në "Raiffeisen Bank" dhe pasi është tërhequr nga kjo bankë (për shkak të interesave të ndryshuara) është depozituar po në shtator të vitit 2005 në Bankën Popullore, aksionet e së cilës janë blerë nga banka "Societe Generale Albania", aktualisht OTP Bank. Kjo shumë e kursyer ka qenë në sistemin bankar para fillimit të detyrës.*

Për të vërtetuar pretendimet, subjekti ka paraqitur dokumentet shkresore, si vijon:

- mandatpagesë nga Banka e Kursimeve në datën 9.12.1999, i cili provon që gjyshi i subjektit H. D. ka tërhequr depozitën e tij në shumën 225.630 lekë (subjekti ka qenë 11 vjeç);
- mandatërheqje *cash* i datës 14.9.2005, nga "Raiffeisen Bank", nga ku rezulton se shuma 603.605,29 lekë është tërhequr nga shtetasi H. D. (subjekti ka qenë 18 vjeç);
- ekstrakt i lëvizjeve të llogarisë në emër të subjektit në OTP Bank, për periudhën 27.9.2013 – 10.2.2020, nga ku rezulton depozitimi i shumës fillestare, investimi i saj në depozitë me afat dhe ecuria e kësaj depozite;
- vërtetim nr. *** prot., datë 11.9.2020, i ISSH-së Korçë për pensionin e gjyshes I. D.;
- vërtetim nr. *** prot., datë 11.9.2020, i ISSH-së Korçë për pensionin e gjyshit H. D..

Nga verifikimi i këtyre dokumenteve rezultoi se nuk kishte të dhëna në lidhje me historikun e depozitës në emër të gjyshërve të subjektit deri në vitin 2013, kur deklarohet si e mbyllur, dhe as të dhëna që shuma është tërhequr prej tyre në këtë vit. Për këtë arsye, Komisioni kreu verifikimet, si vijojnë:

- Subjekti, në përgjigjet e pyetësorit nr. ***, ka dhënë të njëjtat sqarime si në përgjigjet e pyetësorit nr. ***, duke saktësuar se pavarësisht se në përshkrimin e veprimit bankar është shënuar "paguar nga H. dhe I. D.", kjo shumë nuk është paguar *cash*, por është transferuar direkt nga llogaria e mbyllur në emër të tyre, në llogarinë e re të çelur në emër të subjektit.
- U kërkuan të dhëna nga OTP Bank, e cila konfirmoi deklaratimet e subjektit, duke informuar se⁸: (i) shtetasit H. dhe I. D. kanë pasur llogari bankare në këtë bankë, të çelur në datën 14.9.2005, në shumën 600.000 lekë; (ii) shuma është investuar dhe riinvestuar në depozitë me afat deri në datën 27.9.2013; (iii) në të njëjtën datë kjo depozitë është mbyllur dhe e gjithë shuma prej 872.200 lekësh është transferuar në llogarinë e subjektit në të njëjtën bankë; (iv) shuma *neto* e interesave të përfuara është 272.280 lekë, e cila është përfshirë si e ardhur në analizën financiare të familjes së origjinës së subjektit.

Për sa i takon burimit të depozitës së gjyshërve me të ardhura të ligjshme, Komisioni ka kryer analizë financiare kumulative me të dhënat që dispononte nga viti 1996 deri më 27.9.2013,

⁸ Shihni shkresën kthim përgjigje nr. *** prot., datë 17.2.2021, të OTP Bank, në dosjen e Komisionit.

pasqyruar në mënyrë të përmbledhur në tabelën në vijim, bazuar në dokumentet shkresore të vëna në dispozicion nga subjekti për anëtarët e familjes prindërore dhe të ardhurat e tyre⁹, e cila rezulton me një balancë pozitive.

Tabela nr. 2

Familja e origjinës së subjektit (në lekë)	Viti 1996 – më 27.9.2013
Të ardhura	8 346 345
Të ardhura nga pensioni i gjyshit	856 625
Të ardhura nga pensioni i gjyshes	856 625
Të ardhura nga paga e babait	2 969 974
Të ardhura nga paga e nënës	3 390 841
Përfituruar nga interesa bankare	272 280
Shpenzime	8 022 479
Shpenzime jetese për 6 persona	6 250 279
Dhuruar subjektit nga familja ¹⁰	1 072 200
Ndryshimi i likuiditeteve	700 000
Mundësia për kursim	323 866

Në këtë analizë, e cila është kryer duke përdorur metodologjinë kumulative pasi familja e origjinës së subjektit (gjyshërit dhe prindërit) nuk ka qenë subjekt deklarimi, janë marrë në konsideratë: (i) të ardhurat nga pagat e prindërve dhe pensionet e të dy gjyshërve, si dhe të ardhura nga interesa bankare të përfituara nga investimi i depozitës; (ii) likuiditetet e pjesëtarëve të familjes sipas informacionit nga bankat e nivelit të dytë; si dhe (iii) shpenzimet e jetesës për 6 persona¹¹. Për sa i takon përlllogaritjes së këtyre shpenzimeve, referuar faktit që familja e subjektit ka jetuar në fshat, faktit që është provuar pagesa e taksës së tokës bujqësore deri në vitin 2020, si dhe faktit që janë vërtetuar të ardhura vjetore nga toka bujqësore, Komisioni ka çmuar që shpenzimet e jetesës të reduktohen në këtë mënyrë: (i) për vitet 1996 – 1999 të konsiderohen si 50 % të të ardhurave familjare; (ii) pas vitit 2000, kur është përdorur standardi i ILDKPKI-së, të reduktohen në masën 40 %, për shkak të produkteve bujqësore dhe blegtorale të përdorura për konsum vetjak nga familja.

Në përfundim të procesit, Komisioni nuk evidentoi dyshime dhe problematika në lidhje me llogarinë bankare objekt shqyrtimi, me burim shumën e dhuruar prej gjyshërve të subjektit në shumën 872.200 lekë, shume e cila u vërtetua ta ketë pasur origjinën në llogarinë e tyre bankare që në vitin 2005 dhe po në rrugë bankare ka kaluar në emër të subjektit në vitin 2013, vit në të cilin znj. Marsela Dervishi ka qenë stazhiere në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

3. Apartament me sip. 78.5 m², i ndodhur në rr. “****”, rezidenca “****”, shk. ***, k. ***, ap. ***, në përdorim, në bazë të kontratës së qirasë datë 1.3.2016. Pronari i banesës është

⁹ Shihni përgjigjet e pyetësorit nr. *** në dosjen e Komisionit.

¹⁰ Këtu është përfshirë shuma 872.200 lekë dhuruar nga gjyshërit dhe kaluar në OTP Bank në datën 27.9.2013, dhe shuma 200.000 lekë kaluar nga nëna V. D. te subjekti në “Raiffeisen Bank” në datën 23.3.2012.

¹¹ Megjithëse nga certifikatat e gjendjes familjare të paraqitura nga subjekti rezulton se gjyshërit e saj janë në trung me vete nga prindërit, bazuar në deklaratimet e subjektit në përgjigje të pyetësorit standard dhe gjatë procesit, deklaratat noteriale nga xhaxhallarët e saj dhe nga fakti që të dy gjyshërit kanë disponuar me testament që e gjithë pasuria e tyre të kalojë tek shtetasi A. D. (babai i subjektit); gjyshërit janë konsideruar pjesë e familjes dhe pensionet/shpenzimet e jetesës/likuiditetet e tyre janë analizuar së bashku me familjen e origjinës së subjektit. Pra, përbërja familjare e subjektit është konsideruar e përbërë nga dy gjyshërit, dy prindërit, vëllai dhe subjekti, deri në nëntor të vitit 2010 kur ajo është larguar për studime në Shkollën e Magjistraturës. Pas largimit të subjektit është shtuar bashkëshortja e vëllait, kështu që përsëri familja përbëhet nga 6 persona.

znj. H. D., e cila e ka fituar pronësinë mbi këtë apartament në bazë të kontratës nr. *** prot., datë 29.7.2014, “amendim i kontratës së shkëmbimit nr. *** prot., datë 30.4.2012. Vlera e qirasë mujore: 20.000 lekë/muaj.

Hetimi i Komisionit në lidhje me këtë pasuri të deklaruar në përdorim

Gjatë hetimit administrativ në lidhje me këtë pasuri u administruan aktet shkresore të vëna në dispozicion nga ILDKPKI-së, si vijojnë¹²:

- kontratë nr. *** prot, datë 29.7.2014, “amendim i kontratës së shkëmbimit nr. *** prot., datë 30.4.2012”, të lidhur mes znj. H. D. dhe shoqërisë “****” sh.p.k.;
- kontratë qiraje datë 1.3.2016, sipas të cilës znj. Marsela Dervishi ka marrë me qira nga znj. H. D. një apartament me sip. 80 m², të ndodhur në rr. “****”, p. “****”, h. ***, shk. ***, ap. ***, Tiranë, me qira mujore 20.000 lekë/muaj, me afat 6-mujor, me të drejtë ripërtëritje me të njëjtat kushte.

Në përgjigjet e pyetësorit nr. ***, subjekti ka deklaruar se ka banuar në këtë banesë në periudhën 1.3.2016 – 30.7.2017, duke dhënë sqarimet përkatëse. Nga data 1.3.2016 deri në deklaratën *Vetting* shpenzimet e qirasë janë përfshirë në analizën financiare.

Përveç sa më sipër, gjatë hetimit administrativ, për shtetasen H. D. u kërkua informacion në drejtim të konfliktit të interesit nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe Fier¹³, nga të cilat nuk rezultuan çështje të shqyrtuara nga gjyqtarja Marsela Dervishi, ku palë pjesëmarrëse të ketë qenë kjo shtetase. Ndërkohë që SPAK-u nuk konfirmoi procedime penale¹⁴ të regjistruara në ngarkim të kësaj shtetaseje.

Në përfundim të hetimit administrativ, në lidhje me këtë pasuri të marrë me qira, nuk rezultuan problematika. Në DPV-në e vitit 2016 kjo pasuri është deklaruar si adresë e regjistrimit në Zyrën e Gjendjes Civile, me përshkrimin “Njësia Bashkiake Nr. ***, Tiranë”, por nuk është deklaruar si pasuri në përdorim, sipas nenit 4 të ligjit nr. 9049/2003.

Subjekti, pasi i është kërkuar të japë sqarime në lidhje me këtë konstatim në parashtrimet e datës 11.3.2021, ka sqaruar se në interpretim të nenit 4 të ligjit nr. 9049/2003 ka vlerësuar se nuk e ka pasur detyrim ligjor për të deklaruar të drejtën e përdorimit të banesës mbi bazën e kontratës së qirasë, për shkak se kjo e drejtë buron nga një marrëdhënie juridike detyrimi. Pra, sipas subjektit nuk ka pasur të drejtë reale mbi banesën e marrë me qira, duke qenë se ka lidhur një kontratë me kundërshpërblim, duke arsyetuar se në pikën 11, të nenit 3, të ligjit nr. 84/2016, ndryshe nga deklaratat periodike, është parashikuar në mënyrë të shprehur detyrimi për të deklaruar pasuritë e paluajtshme dhe të drejtat reale mbi to, në pronësi dhe në përdorim të subjektit të rivlerësimit dhe në zbatim të këtij detyrimi ajo ka deklaruar edhe banesën e marrë me qira si një send në përdorim.

Për sa i takon këtyre pretendimeve, Komisioni vlerëson se sipas parashikimit të germës “a”, të pikës 1, të nenit 4, të ligjit nr. 9049/2003, subjekti ka pasur detyrimin të deklarojë pasuritë e paluajtshme dhe të drejtat reale mbi to, që në rastin konkret është përdorimi për shkak të marrëdhënies juridiko-civile të qiramarrjes. Në Kodin Civil parashikohen të drejtat reale, ndër të cilat është edhe e drejta e përdorimit dhe e banimit dhe, në këtë kuptim, subjekti ka pasur detyrimin të deklaronte përdorimin e kësaj banese për qëllime banimi në kushtet e qiramarrjes. Por mosdeklarimi në DPV-në e vitit 2016 çmohet nga Komisioni një pasaktësi e llojit formal dhe pa pasojë, e cila është korrigjuar në deklaratën *Vetting*.

¹² Shihni aktet në Aneksin *** në dosjen e ILDKPKI-së.

¹³ Shihni shkresën kthim përgjigje nr. *** prot., datë 16.2.2021, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe shkresën kthim përgjigje nr. *** prot., datë 10.2.2021, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, në dosjen e Komisionit.

¹⁴ Shihni shkresën kthim përgjigje nr. *** prot., datë 12.2.2021 të SPAK, në dosjen e Komisionit.

Në rubrikën “detyrime financiare”, subjekti ka deklaruar: “Marrëveshje huaje në llogari rrjedhëse (overdraft) e lidhur në datën 12.10.2016, ndërmjet palëve: huadhënësi ‘Credins Bank’ sh.a. dhe huamarrësja Marsela Dervishi. Qëllimi i përdorimit: për arsye personale. Shuma e huas është në vlerën 240.000 lekë dhe është lidhur për një afat 12 muaj. Norma e interesit me bazë vjetore është 12 % në vit. Shuma e detyrimit e mbetur pa shlyer deri në datën 25.1.2017, është 39.635,5 lekë.”

Gjatë hetimit administrativ, nga aktet në dosje¹⁵ u konstatua se: (i) me kontratën e kredisë bankare të datës 12.10.2016, znj. Marsela Dervishi ka marrë nga “Credins Bank” hua në shumën 240.000 lekë, me afat 12-mujor me të drejtë rinovimi, me interes 12 %; (ii) kjo kredi kufi është deklaruar në DPV-në e vitit 2016 njësoj si në deklaratën *Vetting*, duke deklaruar shumën e shlyer dhe detyrimin e mbetur.

Deklaratë e pasurisë së personit të lidhur I. N., bashkëjetuesi i subjektit

Ky shtetas ka plotësuar autorizimin për kontrollin e deklaratës së interesave, ku ka evidentuar se ka pasuri veçmas të regjistruar në emrin e tij, duke deklaruar:

Gjendje likuiditeti cash jashtë sistemit bankar, në shumën 1.300.000 lekë

Burimi i krijimit: dhuratë nga prindërit, si rezultat i marrjes së pensionit të pleqërisë në Shqipëri për periudhën shtator të vitit 2009 – aktualisht.

Hetimi i Komisionit në lidhje me këtë likuiditet

Gjatë hetimit administrativ rezultoi se subjekti ka deklaruar bashkëjetesën për herë të parë në DPV-në e vitit 2015, në të cilën ka deklaruar bashkëjetesën edhe bashkëjetuesi i saj¹⁶. Në DPV-në e vitit 2015 bashkëjetuesi I. N. ka deklaruar: “Kursime cash të mbajtura jashtë sistemit bankar në vlerën 1.300.000 lekë”. Burimi i krijimit: dhuratë nga prindërit si rezultat i marrjes së pensionit të pleqërisë në Shqipëri për periudhën 2009 – 2015. Të njëjtin deklaram ka bërë edhe në deklaratën *Vetting*.

Në lidhje me burimin e krijimit të këtij likuiditeti, subjekti ka paraqitur në ILDKPKI vërtetimet nr. *** prot., dhe nr. *** prot., datë 24.10.2016, të ISSH-së, ku vërtetohet masa e pensionit mujor në vlerën 14.785 lekë për secilin nga prindërit e bashkëjetuesit¹⁷. Ndërsa në pyetësonin standard, subjekti ka paraqitur: (i) pasaportë të prindërve të bashkëjetuesit, ku duket se të dy kanë dalë nga Shqipëria në datën 14.8.2009; dhe (ii) lejen e qëndrimit të përhershme për secilin nga prindërit në Kanada.

Gjatë hetimit administrativ subjektit iu kërkua të provojë me dokumente shkresore: (i) masën e pensionit të prindërve të bashkëjetuesit për periudhën shtator 2009 – dhjetor 2015; (ii) mënyrën e tërheqjes së shumave të pensionit dhe kalimin e tyre te bashkëjetuesi i subjektit; si dhe (iii) informacionin se ku banojnë prindërit e tij në Kanada dhe me çfarë të ardhurash e përballojnë jetesën.

Për sa i takon vendbanimit dhe të ardhurave me të cilat përballojnë jetesën, në përgjigjet e pyetësonit nr. *** subjekti ka dhënë sqarime të hollësishme, si dhe ka paraqitur prova shkresore të përkthyer, noterizuara dhe legalizuara sipas ligjit, sipas të cilave vërtetohet se prindërit e bashkëjetuesit, shtetas kanadezë, kanë shkuar në Kanada që në gusht të vitit 2009 nën sponsorizimin e djalit të tyre N. N. dhe janë bërë rezident në shtetin kanadez që prej vitit 1999 sipas një marrëveshje të sponsorizimit në kuadër të procedurave të bashkimit familjar me

¹⁵ Shihni Aneksin ***, në dosjen e ILDKPKI-së dhe shkresën nr. *** prot., datë 11.12.2020, të “Credins Bank” në dosjen e Komisionit.

¹⁶ Në datën 16.10.2015 ka lindur fëmija i parë.

¹⁷ Shihni Aneksin *** në dosjen e ILDKPKI-së.

prindërit e tij. Gjithashtu, subjekti ka paraqitur dokumente që vërtetojnë të ardhurat e shtetasit N. N. në Kanada për vitet 2009, 2010, 2011, 2012, 2013, 2014 dhe 2015.

Për sa i takon të ardhurave me burim nga pensionet e prindërve të bashkëjetuesit, në përgjigje të pyetësorëve nr. *** dhe nr. ***, subjekti ka dhënë sqarime të detajuara, duke deklaruar se gjatë periudhës që prindërit e bashkëjetuesit kanë jetuar në Kanada, ai ka përfituar shumat mujore të pensionit të pleqërisë së tyre në Shqipëri, për tërheqjen e të cilave janë autorizuar shtetasja M. Gj., motra e nënës së bashkëjetuesit dhe shtetasi Q. Gj., bashkëshorti i saj, banues në Bilisht, dhe se me një pjesë të pensioneve këta shtetas kanë bërë pagesat mujore të kështit të kredisë së marrë nga bashkëjetuesi i subjektit në “Raiffeisen Bank”. Për të vërtetuar këto pretendime, subjekti ka paraqitur disa dokumente shkresore, nga marrja në shqyrtim e të cilave rezultoi e vërtetuar se: (i) masa e pensionit të prindërve të bashkëjetuesit për periudhën 14.8.2009 – 1.8.2015 ka qenë në shumën 2.051.520 lekë; (ii) shumat e pensioneve janë tërhequr rregullisht me pëlqimin e prindërve të bashkëjetuesit nga shtetasit M. dhe Q. Gj., e vërtetuar në pjesën më të madhe me listëpagesa dhe/ose mandatpagesa të firmosura prej tyre në degën e Postës Shqiptare, Bilisht; (iii) nga lëvizjet e llogarisë bankare të shtetasit I. N. në “Raiffeisen Bank”, rezultoi i vërtetuar pretendimi i subjektit për pagesat e kësteve të kredisë së bashkëjetuesit nga ana e shtetasve Q. dhe M. Gj.¹⁸.

Përveç sa më sipër, nga të dhënat e sistemit *TIMS*, rezulton se shtetasi R. N. ka dalë nga Shqipëria në vitin 2009 dhe ka një hyrje në prill të vitit 2013, vit në të cilin ka dalë përsëri në korrik të vitit 2013, ndërsa shtetasja D. N. ka dalë në vitin 2009 dhe nuk rezulton të ketë hyrje përsëri, fakte që përkojnë me deklaratimet e subjektit dhe vërtetojnë pamundësinë e tyre për të tërhequr vetë pensionet e pleqërisë.

Sa i takon burimit të ligjshëm të likuiditetit prej 1.300.000 lekësh, deklaruar prej bashkëjetuesit të subjektit në DPV-në e vitit 2015, Komisioni kreu analizën financiare, duke përfshirë edhe shumën prej 400.000 lekësh që z. I. N. ka depozituar në llogarinë e tij në “Raiffeisen Bank” brenda të njëjtit vit, në datën 8.6.2015¹⁹.

Në lidhje me burimin e krijimit të shumës 400.000 lekë, subjekti, pasi u pyet nga Komisioni, në përgjigje të pyetësorit nr. *** ka deklaruar se si burim për krijimin saj kanë shërbyer të ardhurat dhe kursimet e bashkëjetuesit nga punësimi, sipas dokumenteve të administruara në dosjen e ILDKPKI-së²⁰, si dhe të ardhura të tjera për të cilat ka paraqitur dokumente shkresore. Nga verifikimi i të gjitha dokumenteve të administruara, si burim për krijimin e shumës 400.000 lekë rezultoi të kenë shërbyer të ardhurat si në vijim:

1) Të ardhurat nga pensionet e prindërve përpara se të largoheshin në Kanada (viti 2009), në total në shumën 932.840 lekë, vërtetuar me vërtetimet nr. ***, datë 29.1.2021 dhe nr. ***, datë 29.1.2021, lëshuar nga ISSH-ja, dega Bilisht.

2) Shuma 700.000 lekë, e përfituar nga shitja e pasurisë tokë livadh, në Bilisht, në vitin 2005, vërtetuar me kontratën e shitblerjes nr. ***, datë 16.5.2005, me shitës R. N., me çmim shitjeje 700.000 lekë, në periudhën kur bashkëjetuesi i subjektit ka jetuar në të njëjtin trung familjar me prindërit. Për këtë të ardhur është paguar tatimi në burim për të ardhurat nga shitja në shumën 3.500 lek, vërtetuar me mandatarkëtimin nr. ***, datë 16.5.2005. Siç vërehet në kontratën e shitjes, emri i shitësit është R. N., ashtu sikurse edhe në dokumentet bashkëngjitur si certifikata e pronësisë (ku ai figuron pronar i vetëm), si dhe letërnjoftimi me nr. serie ***, lëshuar në datën 12.11.1980. Ndërkohë që emri i babait H. dhe vitlindja 1938 janë njësoj me

¹⁸ Nga lëvizjet e llogarisë bankare të shtetasit I. N. në “Raiffeisen Bank” rezultoi i vërtetuar pretendimi i subjektit për pagesat e kësteve të kredisë së tij nga shtetasit Q. dhe M. Gj..

¹⁹ Vërtetuar me shkresën nr. *** prot., datë 9.12.2020, të “Raiffeisen Bank”, administruar nga Komisioni.

²⁰ Shihni përgjigjet e subjektit në pyetësorët nr. *** dhe nr. *** në dosjen e Komisionit, si dhe aktet në Aneksin *** dhe *** në dosjen e ILDKPKI-së.

ato të babait të bashkëjetuesit, z. R. N.. Me njoftimin e rezultateve të hetimit, subjektit i është kërkuar të japë sqarime lidhur dy mbiemrat “N.” dhe “N.”, duke vënë në dispozicion dokumente që vërtetojnë faktin që bëhet fjalë për të njëjtin shtetas. Gjithashtu, subjektit i është kërkuar të paraqesë dokumente që vërtetojnë origjinën dhe mënyrën e fitimit të pronësisë së shtetasit R. N./N. mbi pasurinë objekt shetjeje.

Në parashtrimet e datës 11.3.2021, subjekti ka dhënë sqarime dhe ka paraqitur dokumente shkresore në lidhje me sa i është kërkuar. Së pari, lidhur me mbiemrat “N.” dhe “N.”, ka sqaruar se familja e bashkëjetuesit të saj ka pasur mbiemrin “N.”, ndryshuar në datën 8.9.2000 në “N.”, vërtetuar me vërtetimin datë 3.3.2021, lëshuar nga Zyra e Gjendjes Civile, Bashkia Devoll. Së dyti, sa i përket origjinës së pasurisë objekt i shitjes me kontratë nr. ***, datë 16.5.2005, subjekti ka sqaruar se sipërfaqja e tokës livadh është përfituar në mënyrë të ligjshme në bazë të vendimit nr. ***, datë 21.1.2000, të Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave ish-Pronarëve dhe ka vënë në dispozicion kopje të njësuar me origjinalin e këtij vendimi, i cili vërteton se z. R. N. është trashëgimtar i z. H. N., që gëzon të gjithë pasurinë e trashëgimtarit dhe se sipërfaqja e livadhit prej 95.000 m² t’i kthehet trashëgimtarit të ish-pronarit H. N..

3) Shuma e kredisë prej 790.000 lekësh, marrë në vitin 2011 nga bashkëjetuesi, vërtetuar me kontratën e kredisë datë 20.9.2011, administruar nga ILDKPKI-ja, e cila u verifikua edhe nga Komisioni nëpërmjet të dhënave bankare të vëna në dispozicion nga “Raiffeisen Bank”, trajtuar në vijim.

Për sa i takon shumave të pretenduara të dërguara gjatë periudhës 2009 – 2016 me shërbimin Western Union dhe dorazi nëpërmjet të njohurve, nga vëllai dhe motra e bashkëjetuesit që jetojnë në Kanada, pretendimet janë në nivel deklarativ dhe, si të tilla, këto shuma nuk u përfshinë në analizën financiare.

Bazuar në të gjitha provat e administruara, nga Njësia e Shërbimit Ligjor u krye analiza financiare si në tabelën më poshtë, për periudhën 2005²¹ - 2015²² i cili ka qenë viti i parë i deklarimit të bashkëjetuesit të subjektit, nga ku duket se z. I. N. ka pasur mundësi me të ardhura të ligjshme për të krijuar likuiditetin prej 1.300.000 lekësh, deklaruar si gjendje *cash* për vitin 2015, si dhe të shumës prej 400.000 lekësh, depozituar në “Raiffeisen Bank” po gjatë vitit 2015.

Tabela nr. 3

Bashkëjetuesi (në lekë)	Periudha 16.5.2005 – 1.8.2015
Të ardhura	5 403 542
Paga e z. I. N.	929 182
Pensioni i babait	1 492 180
Pensioni i nënës	1 492 180
Nga shitja e pronës më 16.5.2005	700 000
Nga kredia e marrë në “Raiffeisen Bank”, 21.9.2011	790 000
Shpenzime	5 238 143
Shpenzime jetese	2 565 843
Depozituar në “Raiffeisen Bank”, 8.6.2015	400 000
<i>Cash</i> i krijuar nga bashkëjetuesi	1 300 000
Paguar kredia në “Raiffeisen Bank”	612 300

²¹ Viti kur prindërit e bashkëjetuesit kanë shitur një tokë të llojit “livadh” në Bilisht.

²² Data 1 gusht i vitit 2015 është konsideruar si data e fillimit të bashkëjetesës së subjektit me z. I. N..

Paguar kredia në “Fondin Besa”	360 000
Mundësia për kursim	165 399

Analiza financiare është bazuar në metodologjinë kumulative, pasi bashkëjetuesi dhe prindërit e tij nuk kanë qenë subjekt i deklarimit të pasurisë në ILDKPKI. Në këtë analizë janë përfshirë: të ardhura nga puna e z. I. N. nga viti 2007 – gusht të vitit 2015, në shumën 929.182 lekë; të ardhura nga shitja e pasurisë së llojit “livadh”, në shumën 700.000 lekë; shuma e kredisë prej 790.000 lekësh marrë nga bashkëjetuesi në vitin 2011 në “Raiffeisen Bank”; si dhe pensionet e prindërve për të njëjtën periudhë në shumën 2.984.360 lekë. Shpenzimet e jetesës janë përlllogaritur për tri persona²³ për periudhën 16.5.2005 – 14.8.2009, ndërsa në vijim vetëm për një person.

Detyrime financiare të deklaruara nga bashkëjetuesi

Kredi bankare në bazë të kontratës së kredisë datë 20.9.2011, të lidhur ndërmjet palës huadhënëse “Raiffeisen Bank” dhe palës huamarrëse I. N.. Shuma totale e kredisë bankare është 790.000 lekë dhe kontrata është lidhur me afat 84 muaj. Qëllimi i përdorimit: për arsye personale. Data e disbursimit: 21.9.2018. Interesi bazë: 17.83 %. Kësti mujor: 16.525,47 lekë. Shuma e mbetur pa shlyer deri në datën 23.1.2017 është 267.699,39 lekë.

Gjatë hetimit administrativ, nga aktet në dosje²⁴ rezultoi se:

- Me anë të kontratës së kredisë bankare datë 20.9.2011, z. I. N. ka marrë në “Raiffeisen Bank” kredi në shumën 790.000 lekë, me afat 84 muaj dhe interes 17.83 %.
- Kjo kredi është deklaruar me të njëjtat kushte prej tij në DPV-të e viteve 2015 dhe 2016, duke deklaruar dhe shumën e detyrimit të mbetur.
- Sa i takon shlyerjes së kredisë, gjatë vitit 2015, para, por edhe pas fillimit të bashkëjetesës me subjektin, kredia e z. I. N. është shlyer nga familja Gj.. Ndërsa, për vitin 2016 këstet e kredisë janë paguar nga subjekti dhe bashkëjetuesi dhe janë përfshirë si shpenzime në analizën e këtij viti. Mundësia financiare e subjektit për të kryer këto pagesa me të ardhura të ligjshme, pasqyrohet në tabelën përmbledhëse të analizës financiare.

KONSTATIME TË TJERA

1. Duke qene se subjekti dhe bashkëjetuesi i saj nuk kanë deklaruar pasuri në pronësi, u kryen disa kërkime, në përfundim të të cilave rezultoi se:

- ASHK-ja vendore²⁵ nuk konfirmoi ndonjë pasuri të regjistruar në emër të subjektit të rivlerësimit, znj. Marsela Dervishi, apo bashkëjetuesit/I. N..
- FSHU-ja²⁶ konfirmoi kontrata të furnizimit me energji në emër të znj. Marsela A. Dervishi apo bashkëjetuesit/I. R. N., ndërkohë që informon se në emër të tij rezulton kontrata nr. ***, në Tiranë, por kjo kontratë e hapur në datën 15.9.1997, u vërtetua se i përket apartamentit të ndodhur në adresën: rr. “****”, p. ***, shk. ***, ap. ***, në emër të shtetasit I. S. N. (sipas sistemit të Zyrës së Gjendjes Civile, i datëlindjes 1963) dhe jo shtetasit I. R. N. i datëlindjes 1980²⁷.

²³ Shtetasit R., D. dhe I. N..

²⁴ Shihni aktet në Aneksin *** në dosjen e ILDKPKI-së dhe shkresën nr. *** prot., datë 9.12.2020, të “Raiffeisen Bank” në dosjen e Komisionit.

²⁵ Shihni shkresat kthim përgjigje nga ASHK-ja në dosjen e Komisionit.

²⁶ Shihni shkresën kthim përgjigje nr. *** prot., datë 10.12.2020, nga FSHU-ja në dosjen e Komisionit.

²⁷ Shihni shkresën kthim përgjigje nr. *** prot., datë 19.2.2021, nga FSHU-ja në dosjen e Komisionit.

- UKT-ja²⁸ nuk ka konfirmuar kontrata për shërbime ujësjellës-kanalizime në emër të subjektit apo bashkëjetuesit/I. N..

- ASHK-ja, Zonat e Stimuluara²⁹, kanë informuar se subjekti dhe bashkëjetuesi i saj nuk rezultojnë të jenë aplikues për ndonjë objekt informal.

2. Në përgjigjet e pyetësorit nr. ***, në lidhje me banesat ku ka jetuar, subjekti është shprehur se:

2.1 Në periudhën 10.10.2012 – 8.4.2013 ka banuar në një garsoniere me qira mujore 3.000 lekë/muaj (plus konsumin e energjisë elektrike), në pronësi të shtetasit F. D., ndodhur në rr. “***”, Tiranë, sipas kontratës së qirasë nr. ***, datë 9.4.2012³⁰. Për këtë shtetas nuk rezultuan³¹ çështje të shqyrtuara nga gjyqtarja Marsela Dervishi, si gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe Fier. Gjithashtu, SPAK-u nuk konfirmoi procedime penale të regjistruara në ngarkim të këtij shtetasi³². Në DDPD-në e vitit 2012 subjekti ka deklaruar si adresë të regjistrimit në gjendjen civile adresën: rr. “***”, banesë private.

2.2 Në periudhën 9.4.2013 – 8.8.2015, në të cilën ka deklaruar si adresë të regjistrimit në gjendjen civile adresën e pasurisë së sipërrajtuar (rr. “***”, Njësia Nr. ***), subjekti ka banuar në një garsoniere me qira në pronësi të z. S. Gj., e ndodhur në rr. “***”, Tiranë. Për këtë banesë ka lidhur kontratë qiraje në formë verbale. Në lidhje me këtë objekt ka deklaruar se ka paguar qira në vlerën 10.000 lekë/muaj (plus konsumin e energjisë). Pas kërkesës së Komisionit në lidhje me marrëdhënien me shtetasin S. Gj. dhe arsyet pse nuk është lidhur kontratë qiraje, subjekti ka sqaruar se me këtë shtetas nuk ka asnjë lidhje familjare, miqësore apo interesi dhe se është vënë në dijeni se jepej garsoniere me qira nga njoftimi publik i bërë nga ky shtetas në afërsi të banesës e cila ndodhej në ***.

Gjatë hetimit administrativ u kërkua informacion për çështje të shqyrtuara në drejtim të konfliktit të interesit nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe Fier, nga ku nuk rezultuan³³ çështje të shqyrtuara nga gjyqtarja Marsela Dervishi, në të cilat palë të ketë qenë shtetasi S. Gj.. Gjithashtu, me kërkesë të Komisionit, SPAK-u nuk konfirmoi procedime penale të regjistruara në ngarkim të një shtetasi me këtë emër³⁴.

Nga verifikimit e kryera, referuar raportit të rivlerësimit profesional, por edhe deklarimeve periodike, në këtë periudhë dhe duke vijuar deri sot, subjekti ka qenë gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fierit. Pas kërkesës së Komisionit në lidhje me banimin në qytetin e Fierit, ku ushtron detyrën e gjyqtares, në përgjigjet e pyetësorit nr. *** subjekti ka sqaruar se gjatë gjithë periudhës që ka ushtruar funksionin në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier ka banuar në qytetin e Tiranës dhe e ka bërë rrugën vajtje-ardhje, sipas rastit, duke u kombinuar me kolegë të jenë dhe duke ndarë shpenzimet e karburantit, apo duke përdorur transportin publik. Bazuar në deklaratimet e subjektit, shpenzimet e qirasë janë përfshirë në analizën financiare të viteve përkatëse, ndërsa shpenzimet e transportit nga vendbanesa në vendin e punës janë konsideruar

²⁸ Shihni shkresën kthim përgjigje nr. *** prot., datë 7.12.2020, nga UKT-ja në dosjen e Komisionit.

²⁹ Shihni shkresën kthim përgjigje nr. *** prot., datë 22.12.2020, nga ASHK-ja, Zonat e Stimuluara, në dosjen e Komisionit.

³⁰ Shihni kontratën bashkëngjitur përgjigjeve të pyetësorit nr. *** në dosjen e Komisionit.

³¹ Shihni shkresën kthim përgjigje nr. *** prot., datë 16.2.2021, nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe shkresën kthim përgjigje nr. *** prot., datë 10.2.2021, nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier, në dosjen e Komisionit.

³² Shihni shkresën kthim përgjigje nr. *** prot., datë 12.2.2021, nga SPAK-u, në dosjen e Komisionit

³³ Shihni shkresën kthim përgjigje nr. *** prot., datë 16.2.2021, nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe shkresën kthim përgjigje nr. *** prot., datë 10.2.2021, nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier, në dosjen e Komisionit.

³⁴ Shihni shkresën kthim përgjigje nr. *** prot., datë 12.2.2021, nga SPAK-u, në dosjen e Komisionit.

në bazë të përgjigjeve të pyetësorit nr. 2³⁵, duke përllogaritur 22 ditë pune në muaj dhe koston e transportit publik në vlerën 300 lekë vajtje dhe 300 lekë ardhje³⁶.

Për të dyja pasuritë e sipërpërmendura nuk rezulton që subjekti të ketë kryer deklarime në DPV-të përkatëse si pasuri në përdorim, sipas nenit 4 të ligjit nr. 9049. Në parashtrimet e tij, subjekti ka sqaruar se në interpretim të nenit 4 të ligjit nr. 9049/2003 ka vlerësuar se nuk e ka pasur detyrim ligjor për të deklaruar të drejtën e përdorimit, për shkak se sipas saj kjo e drejtë buron nga një marrëdhënie juridike detyrimi (kontratë qiraje).

Pavarësisht argumenteve të subjektit, Komisioni vlerësoi se sipas parashikimit të germës “a”, të pikës 1, të nenit 4, të ligjit nr. 9049/2003 subjekti ka pasur detyrimin të deklarojë pasuritë e paluajtshme dhe të drejtat reale mbi to, që në rastin konkret është përdorimi për shkak të marrëdhënies juridiko-civile të qiramarrjes. Por, mosdeklarimet në DPV-të përkatëse të pasurive në përdorim si më sipër, në përfundim të procesit u çmuan nga Komisioni si pasaktësi të llojit formal dhe pa pasoja, që nuk penalizojnë subjektin e rivlerësimit. Për të arritur në këtë përfundim, Komisioni çmoi edhe deklarimet e detajuara të subjektit në pyetësorin standard në lidhje me çdo pasuri të përdorur prej saj, qoftë edhe në periudha të shkurtra kohore, për të gjithë periudhën e kërkuar.

2.3 Në periudhën 10.8.2015 – 10.12.2015 ka deklaruar se ka banuar në Toronto, Kanada në banesën e motrës së bashkëjetuesit, znj. A. N., me adresë: *Scarborough, ***,* me statusin e vizitorit të përkohshëm dhe nuk ka paguar qira. Nga dokumentet shkresore të administruara, rezulton që kjo është periudha e lindjes së fëmijës së parë i cili ka lindur më 16.10.2015, në Kanada. Në përgjigje të pyetësorit standard subjekti sqaron se shpenzimet për udhëtimin në Kanada janë në vlerën 2.500 euro dhe se burimi i këtij shpenzimi janë të ardhurat nga paga, si dhe kursimet personale. Këto shpenzime janë përfshirë në analizën financiare të vitit 2015.

2.4 Në periudhën 10.12.2015 – 28.2.2016 ka banuar në Bilisht, Devoll dhe ka deklaruar se ka banuar në banesën në pronësi të prindërve të saj, me adresë: rr. “***”, Bilisht. Nga vërtetimet e pagave, rezulton se gjatë kësaj periudhe subjekti ka qenë me leje lindjeje. Gjatë hetimit administrativ, me kërkesë të Komisionit, ASHK-ja Devoll³⁷ ka vërtetuar pronësinë e babait të subjektit A. D. mbi pasurinë shtëpi banimi + truall, ndodhur në Bilisht, Devoll, me sip. 189 m², nga e cila 50 m² është ndërtesë, me nr. pasurie ***, ashtu sikurse edhe pronësinë mbi 8 pasuri të llojit “arë”, në Devoll.

3. Nga verifikimi i deklarimeve periodike, konstatohet se në DPV-në e vitit 2015, në rubrikën “të dhëna konfidenciale”, subjekti ka deklaruar *pagesa e shpenzimeve spitalore në Kanada nga z. N. N., në vlerën 3.500 dollarë, për të cilat në përgjigje të pyetësorit standard është shprehur se në këto shpenzime përfshihen: 1.811 dollarë për një natë qëndrimi në spital; 1.500 dollarë pagesa e mjekut që do të ndiqte shtatzëninë për periudhën e mbetur dhe do të asistonte në lindjen e fëmijës; dhe 300 dollarë për disa shërbime klinike para lindjes pranë spitalit. Në lidhje me këto pagesa subjekti ka sqaruar se sipas legjislacionit kanadez, për shtetasit jo rezidentë (që nuk përfitonin nga siguracioni), të cilët do të përfitonin shërbime spitalore (me përjashtim të urgjencës), duhet të bëhej parapagimi i tyre. Burim i shumës janë të ardhurat nga paga e z. N. N.. Siç vërehet në shpjegimet e subjektit si më sipër, shuma në total ka qenë 3.611 CAD dhe jo 3.500 CAD, siç është deklaruar nga subjekti në DPV-në e vitit 2015. Për të vërtetuar këto pretendime, subjekti ka paraqitur dokumentet si vijojnë:*

³⁵ Subjekti ka deklaruar se ka përdorur transportin publik duke paguar biletë në shumën 250 lekë nga Fieri në Tiranë për periudhën 23.1.2014 – 30.7.2015 dhe periudhën 1.9.2016 – 31.12.2015. Ndërkohë që për periudhën 1.8.2015 – 1.9.2016 nuk ka pasur shpenzime transporti, pasi ka qenë me leje të zakonshme dhe leje lindjeje.

³⁶ Çmimet e biletave Tiranë-Fier-Tiranë janë nxjerrë nga website i kompanive të transportit interurban që operojnë në treg.

³⁷ Shihni shkresën kthim përgjigje nr. *** prot., datë 18.12.2020, nga ASHK-ja Devoll, në dosjen e Komisionit.

- tri fatura spitalore të paguara gjatë vitit 2015, në shumën totale 3.611 CAD³⁸;
- fletëdalje nga spitali, datë 17.10.2015, në të cilën janë shënuar të dhënat për datën e lindjes së fëmijës dhe datën e daljes nga spitali;
- deklarata e të ardhurave vjetore për vitin 2015 e z. N. N., sipas të cilës të ardhurat *neto* për këtë vit janë në shumën 50.327 CAD.

Sa i takon të ardhurave që kanë shërbyer si burim për krijimin e shumës 3.611 CAD, sponsorizuar nga vëllai i bashkëjetuesit, z. N. N., subjektit i është kërkuar të japë sqarime dhe të paraqesë dokumente shkresore dhe në përgjigje të pyetësorëve nr. ***, ***, dhe *** ka dhënë shpjegime të detajuara dhe ka paraqitur dokumente shkresore në formën e kërkuar nga ligji, në analizë të të cilave, në përfundim të hetimit administrativ, u vërtetua se vëllai i bashkëjetuesit, z. N. N. dhe familja e tij, për periudhën 2009 – 2015 kanë pasur në total të ardhura në shumën 412.636 CAD dhe shpenzime jetese për të njëjtën periudhë, sipas Zyrës së Statistikës në Kanada³⁹, në shumën 397.730 CAD. Duket se ky shtetas ka pasur mundësi për të sponsorizuar shumën prej 3.611 CAD të paguara për lindjen e fëmijës së subjektit në Kanada, sipas deklarimit të znj. Dervishi.

Sa i takon dokumentacionit që vërteton shpenzimet për lindjen e fëmijës në total prej 3.611 CAD, në aktet shkresore të paraqitura vërehet se nga tri dokumentet që vërtetojnë pagesa shpenzimesh, njëra prej tyre është mandatpagesë me datë 19.8.2015, për shumën 1.500 CAD në favor të mjekes Sh. R. O., ndërsa dy dokumentet e tjera janë të një formati tjetër, të lëshuara nga spitali “****”, për shumën në total prej 2.111 CAD. Nga këto tri dokumente të cilat i përkasin një periudhe përpara datës së lindjes, 16.10.2015, është e paqartë se cila është shuma totale e shpenzimeve të lindjes dhe çdo shpenzimi tjetër që lidhet me lindjen. Me qëllim heqjen e çdo dyshimi se subjekti mund të kishte pagur një shumë më të madhe se ajo e deklaruar si mbështetje nga vëllai i bashkëjetuesit të saj, me kalimin e barrës se provës i është kërkuar të japë sqarime të mëtejshme për shpenzimet e lindjes, duke vënë në dispozicion shpjegime të mëtejshme dhe dokumente shkresore lëshuar nga spitali që vërtetojnë shtrimin dhe daljen, si dhe dokumente që vërtetojnë shpenzimet spitalore për shtrimin dhe lindjen.

Në prapësimet e saj, subjekti ka dhënë shpjegime të detajuara, duke deklaruar se për të gjitha dokumentet e paraqitura, për sa i përket shpenzimeve spitalore për lindjen e fëmijës, disponon dhe ka paraqitur dokumentet origjinale të lëshuara sipas formatit zyrtar të miratuar në shtetin kanadez, duke sqaruar se sipas praktikës së ndjekur në këtë shtet për të përfituar shërbim mjekësor obstetrik-gjinekologjik, nga personat jo rezidentë kërkohet të ndiqen hapa të caktuar, të cilat subjekti i ka kryer si vijon:

Së pari, në datën 19.8.2015 është kryer regjistrimi fillestar pranë mjekes Sh. R. O.⁴⁰, e cila do të ndiqte shtatzëninë dhe do të asistonte në lindjen e fëmijës, si dhe parapagimi i shumës 1.500 CAD për mjekun⁴¹. Mandatpagesa në formë origjinale është depozituar në Komision bashkëlidhur pyetësorit standard.

Së dyti, në datën 28.8.2015 subjekti ka kryer regjistrimin në spitalin “****”, duke plotësuar formularin për aplikimin e qëndrimit dhe parapagimin e shpenzimeve spitalore në vlerën e përcaktuar prej 1.800 CAD për personat jo rezidentë, vërtetuar nga mandatpagesa, e cila në formë origjinale është depozituar në Komision bashkëlidhur pyetësorit standard (vlera e paguar 1.811 CAD).

Së treti, në datën 15.10.2015 është kryer pagesa prej 300 CAD në spitalin “****”, për një vizitë mjekësore e cila nuk përfshihej në shumën e parapaguar për lindjen e fëmijës. Fatura përkatëse

³⁸ Kursi i këmbimit 1 CAD = 90.53 lekë, Banka e Shqipërisë, më 31.12.2015.

³⁹ <https://www.150.statcan.gc.ca/t1/tb11/en/tv.action?pid=1110022301>

⁴⁰ Mjekja Sh. R. O. ishte e punësuar në këtë spital.

⁴¹ “*Doctor’s delivery fee*” ose sipas përkthimit zyrtar “Tarifa e mjekut për lindje”.

është depozituar në Komision bashkëlidhur pyetësorit standard. Në datën 16.10.2015 subjekti ka lindur në mënyrë natyrale dhe ka dalë nga spitali më 17.10.2015, fakte të cilat provojnë se është paraqitur për të lindur në të njëjtën datë të lindjes dhe ka qëndruar në spital vetëm një natë.

Së katërti, në lidhje me lëshimin e dy formateve të ndryshme të mandatpagesave, subjekti sqaron se pagesat janë bërë aty ku është marrë shërbimi dhe konkretisht, pagesa e tarifës së lindjes për mjekun është lëshuar në zyrën/klinikën e mjekes Sh. R. O., ndërsa pagesat për akomodimin dhe vizitën e kryer në spital janë lëshuar nga ky i fundit. Subjekti vë në dukje se pavarësisht këtij fakti, të gjitha pagesat janë bërë në funksion të mbulimit të shpenzimeve të lindjes së fëmijës, sikurse rezulton edhe nga përshkrimi i bërë në këto mandate, si dhe nga dokumentet e tjera mbështetëse.

Për të vërtetuar pretendimet e saj, subjekti ka paraqitur dokumentet origjinale, si vijon:

- formularin e aplikimit për qëndrimin në spital, nënshkruar nga subjekti dhe përfaqësuesja e spitalit, në të cilin evidentohet se për një pacient jo rezident çmimi i qëndrimit në spital për një ditë është 1.800 CAD;
- certifikatën e regjistrimit të të sapolindurit, në të cilën evidentohet se lindja e fëmijës është kryer në mënyrë natyrale (SVP).

Pasi nga Komisioni u kryen verifikimet në faqen zyrtare të spitalit “***”⁴², ku ka lindur fëmija, rezultoi se: (i) pacientët e pasiguruar, sikurse është rasti i subjektit e cila ka statusin jo rezident, duhet të paguajnë paraprakisht dhe se pagesa e mjekut që asiston në lindje paguhet më vete; (ii) mjekja⁴³ e cila ka lëshuar mandatpagesën në shumën 1.500 CAD punon në këtë spital edhe sot; (iii) tarifata e çmimeve të publikuara sot janë të ndryshme nga ato të faturave të paguara nga subjekti, por këto tarifa janë objekt ndryshimi në kohë dhe negocimi me mjekun.

Bazuar në sa më sipër, subjekti ka shpjeguar në mënyrë bindëse e të dokumentuar se shpenzimet e lindjes janë aq sa ka deklaruar në DPV-në e vitit 2015, në pyetësorin standard dhe gjatë procesit të rivlerësimit, në total prej 3.611 CAD, paguar prej vëllait të bashkëjetuesit, z. N. N., shumë në të cilën përfshihen: (i) tarifën e mjekut prej 1.500 CAD për lindjen e fëmijës; (ii) tarifën e spitalit prej 1.811 CAD për një natë qëndrimi⁴⁴; si dhe (iii) tarifën për vizitën mjekësore prej 300 CAD të kryer një ditë para lindjes.

4. Në DPV-në e vitit 2016, në rubrikën “të dhëna konfidenciale”, subjekti ka deklaruar: (i) *dhuratë për ditëlindjen e parë të djalit, nga znj. A. N. (motra e bashkëjetuesit) në shumën 700 dollarë; dhe (ii) dhuratë nëpërmjet dërgimit të shumave cash nga Kanadaja dhe Greqia, nga znj. A. N. dhe znj. V. N. në shumën 655 euro.*

Në përgjigje të pyetësorit standard, subjekti ka dhënë sqarime të hollësishme në lidhje me këto dhurime dhe burimet e tyre, duke vënë në dispozicion dokumentet shkresore të legalizuara sipas ligjit, nga marrja në shqyrtim e të cilave rezultoi se:

- Nëpërmjet Western Union janë dërguar nga Kanadaja prej znj. A. N.: (i) shuma 700 CAD në datën 15.10.2016 (në datën 16.10.2015 ka lindur fëmija); (ii) shuma 588 CAD në periudha të ndryshme të vitit 2016, tërhequr në euro dhe lekë. Shuma në total prej 1.288,65 CAD ka si burim të ardhurat e kësaj shtetaseje për vitin 2016, dokumentuar në shumën 28.502 CAD. Referuar shpenzimeve të jetesës në shumën 26.016 CAD, duket se znj. A. N. ka pasur mundësi

⁴² www.shn.ca/hospital-fees.

⁴³ ***

⁴⁴ Data e lindjes është 16.10.2015 dhe data e daljes është 17.10.2015, sipas dokumentit “vlerësimi i verdhëzës dhe përmbledhja e daljes nga spitali” lëshuar nga spitali “***”, paraqitur me pyetësorin standard.

për dhurimin e shumës 1.288,65 CAD ose 122.538 lekë, e cila është konsideruar si e ardhur në analizën financiare.

- Nëpërmjet Western Union, znj. V. N. ka dërguar shumën 150 euro nga Greqia, për të cilën nuk janë paraqitur dokumente që vërtetojnë të ardhura. Kjo shumë nuk është konsideruar si e ardhur në analizën financiare.

5. Nga verifikimi i të dhënave të hyrje-daljeve nga sistemi *TIMS* rezultoi se subjekti i rivlerësimit dhe bashkëjetuesi i saj kanë udhëtuar jashtë shtetit me automjetet me targa *** dhe ***. Në lidhje me pronësinë e këtyre automjeteve, përkatësisht në pronësi të vëllait të bashkëjetuesit, z. N. N. dhe të shoqërisë “****”, në përgjigjet e pyetësorit nr. *** subjekti ka dhënë shpjegime të hollësishme, deklarime të cilat përputhen me të dhënat e sistemit të AMF-së, si dhe ka dhënë sqarime në lidhje me qëllimet e udhëtimeve dhe personat me të cilët ka udhëtuar. Për këta persona, konkretisht, N. N., I. D. dhe L. P. dhe shoqëria “****”, Komisioni kërkoi informacion nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe Fier, nga ku nuk rezultuan të dhëna për çështje të shqyrtuara nga gjyqtarja Marsela Dervishi⁴⁵. Gjithashtu, me kërkesë të Komisionit, SPAK-u nuk konfirmoi procedime penale të regjistruara në ngarkim të shtetasve të mësipërm⁴⁶.

6. Nga informacioni i marrë nga DPPPP-ja⁴⁷ nuk u konfirmuan raportime për transaksione bankare në emër të subjektit dhe bashkëjetuesit të saj.

7. Nga të dhënat e regjistrit noterial⁴⁸ nuk u konstatuan veprime të tjera noteriale për shitblerje pasurish të luajtshme dhe të paluajtshme nga subjekti i rivlerësimit dhe bashkëjetuesi i saj.

8. Nga lëvizjet e disa llogarive bankare rezultojnë veprime të kryera nga subjekti dhe bashkëjetuesi para bashkëjetesës. Konkretisht:

8.1. Në datën 19.3.2015 subjekti ka depozituar në llogarinë e saj në “Credins Bank” shumën 150.000 lekë. Me kërkesë të Komisionit, në përgjigje të pyetësorit nr. *** subjekti ka deklaruar se burim i kësaj shume janë të ardhurat dhe kursimet e saj nga paga dhe se në vitin 2015 ka pasur kursime *cash* nga paga në vlerën 300.000 lekë, të mbartura nga viti 2014, të cilat janë shpenzuar. Gjithashtu, subjekti deklaroi se gjatë vitit 2015 ka pakësuar edhe llogarinë e depozitës bankare, duke tërhequr shumën prej 250.000 lekësh⁴⁹.

Nga verifikimi i lëvizjeve të llogarisë në OTP Bank u konstatua se në datën 20.2.2015 subjekti ka tërhequr shumën 170.000 lekë, e cila sipas sqarimeve të subjektit ka gjasa të ketë shërbyer për depozitim e shumës 150.000 lekë në datën 19.3.2015. Gjithashtu, subjekti ka pasur gjendje *cash* në shumën 600.000 lekë, e cila mund të ketë shërbyer për krijimin e depozitës prej 150.000 lekësh. Për rrjedhojë, është vlerësuar se subjekti ka pasur të ardhura të ligjshme për krijimin e shumës 150.000 lekë, të depozituara në “Credins Bank”.

8.2. Në datën 25.3.2015 z. I. N. ka depozituar në “Tirana Bank” në llogarinë e znj. V. D. (nëna e subjektit), shumën 100.000 lekë.

Me kërkesë të Komisionit, në përgjigje të pyetësorit nr. *** subjekti ka deklaruar se bashkëjetuesi ka depozituar shumën 100.000 lekë për llogari të saj, pasi ajo nuk ka pasur kohë ta kryejë këtë veprim personalisht. Subjekti sqaroi se kjo shumë i është kthyer nga nëna e saj në muajin korrik të vitit 2015. Si burim të kësaj shume subjekti deklaroi të ardhurat dhe

⁴⁵ Shihni shkresën kthim përgjigje nr. *** prot., datë 16.2.2021, nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe shkresën kthim përgjigje nr. *** prot., datë 10.2.2021, nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier, në dosjen e Komisionit.

⁴⁶ Shihni shkresën kthim përgjigje nr. *** prot., datë 12.2.2021, nga SPAK-u, në dosjen e Komisionit.

⁴⁷ Shihni shkresën kthim përgjigje nr. *** prot., datë 7.12.2020, nga DPPPP-ja, në dosjen e Komisionit.

⁴⁸ Shihni shkresën kthim përgjigje nr. *** prot., datë 9.12.2020, nga Ministria e Drejtësisë, në dosjen e Komisionit.

⁴⁹ Bashkëlidhur pyetësorit nr. ***, subjekti ka paraqitur *statement* të llogarisë së kursimit në OTP Bank, ku pasqyrohen pikësimet e kësaj depozite.

kursimet e saj nga paga. Sipas analizës financiare mbi mundësinë e krijimit të kësaj shume në datën 25.3.2015, rezulton se subjekti ka pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për të krijuar këtë shumë.

Tabela nr. 4

Përshkrimi	Data 25.3.2015
Pasuri	- 190 497
Shtesa/Pakësime, likuiditete	-190 497
Likuiditete gjendje	1 257 895
Të ardhura, dokumentuar	261 070
Të ardhura nga pagat e subjektit	261 070
Shpenzime	225 669
Shpenzime jetese	56 069
Shpenzime qiraje	30 000
Shpenzime udhëtimi të brendshëm sipas pyetësorit nr. ***	39 600
Derdhur në llogari të nënës V. D.	100 000
Mundësia për kursime	225 898

Analiza financiare

Në përfundim të hetimit administrativ u krye analiza financiare për të gjithë periudhën e rivlerësimit, pasqyruar në tabelën si vijon:

Tabela nr. 5

Përshkrimi	2012	2013	2014	2015	2016	TOTAL
1. Pasuri	-32 625	1 275 489	5 528	1 648 041	-832 599	2 063 834
2. Të ardhura	194 840	1 773 205	1 201 647	2 611 656	864 871	6 646 219
3. Shpenzime	43 887	245 024	580 198	807 381	1 268 452	2 944 942
Mundësia për kursime (2-1-3)	183 578	252 692	615 921	156 235	429 017	1 637 443

Metodologjia e përdorur

Në analizën financiare, për çdo pasuri të krijuar dhe/ose shpenzim të kryer, është analizuar mundësia financiare e subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur me të, duke krahasuar në çdo rast informacionet e marra në rrugë zyrtare nga institucionet kompetente ligjore me deklaratimet e subjektit. Kjo analizë është kryer duke marrë në konsideratë:

Të ardhurat

- Të ardhurat nga punësimi, të dokumentuara, të subjektit dhe bashkëjetuesit të saj.
- Për subjektin janë përfshirë⁵⁰ bursa nga Shkolla e Magjistraturës për periudhën para emërimit në detyrë për vitet 2010 - 2012; pagat nga emërimi në detyrë në datën 10.10.2012 dhe deri në fund të periudhës së vlerësimit. Për bashkëjetuesin e subjektit, z. I. N., janë përfshirë pagat nga

⁵⁰ Sipas vërtetimeve për pagat e subjektit, të cilat gjenden në Aneksin *** të dosjes së administruar nga ILDKPKI-ja.

punësimi⁵¹ dhe çdo e ardhur tjetër⁵² që ka shërbyer si burim për krijimin e likuiditeteve të deklaruara prej tij, nga momenti i fillimit të bashkëjetesës me subjektin.

- Janë përfshirë si të ardhura likuiditetet e deklaruara dhe të krijuara nga bashkëjetuesi përpara bashkëjetesës me subjektin, pasi u provua që ato ishin krijuar me të ardhura të ligjshme.

- Dhuratat e marra nga subjekti dhe bashkëjetuesi, pasi u provuan se ato ishin nga të ardhura të ligjshme të dhuruesve, dhe konkretisht, likuiditeti i dhuruar nga gjyshërit e subjektit në vitin 2013; dhuratë nga z. N. N. për pagesën e shpenzimeve të lindjes së fëmijës së subjektit në vitin 2015; dhuratë e sjellë nga motra e bashkëjetuesit nga Kanadaja në vitin 2016.

- Të ardhura nga interesat bankare⁵³.

Shpenzimet

- Shpenzimet e jetesës janë përlllogaritur bazuar në standardin e ILDKPKI-së⁵⁴ dhe sipas përbërjes familjare⁵⁵ të subjektit të rivlerësimit.

- Shpenzimet e udhëtimit sipas raportit të sistemit *TIMS* dhe sqarimeve të dhëna nga subjekti në pyetësorin standard. Metodologjia e përlllogaritjes së këtyre shpenzimeve është ajo e përcaktuar në vendimin (JR) nr. 11, datë 22.5.2019, të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit.

- Shpenzimet e udhëtimit të brendshëm nga vendbanesa në vendin e punës janë vlerësuar bazuar në deklaratimet e subjektit, si dhe nga verifikimet e kryera në lidhje me çmimin e biletave. Një muaj është konsideruar me 22 ditë pune dhe çmimi i biletës Tiranë-Fier-Tiranë është 600 lekë për një udhëtim vajtje-ardhje. Nuk janë përlllogaritur shpenzime udhëtimit të brendshëm për periudhën 1.8.2015 – 1.9.2016, kur subjekti ka qenë me leje lindje.

- Shpenzime të tjera në të cilat përfshihen shpenzime qiraje⁵⁶, shpenzime për kopshtin e fëmijës⁵⁷, depozitime të kryera nga subjekti në llogari të personave të tretë⁵⁸, sikurse janë evidentuar nga lëvizjet bankare, pagesat e kësteve të kredisë së bashkëjetuesit pas datës 1.8.2015.

Pasuritë

E vetmja pasuri e krijuar nga subjekti gjatë periudhës së rivlerësimit janë likuiditetet. Si të tilla janë konsideruar gjendjet e llogarive bankare⁵⁹ në fund të çdo viti/date të analizuar dhe gjendjet *cash*, sikurse janë deklaruar nga subjekti në DPV-të përkatëse, si dhe sqarimet e dhëna në përgjigje të pyetësorëve gjatë procesit të rivlerësimit. Ndryshimi i likuiditeteve, pakësimi ose shtesa nga viti në vit është pasuria e krijuar nga subjekti për një vit të caktuar ushtrimor.

⁵¹ Sipas vërtetimeve për pagat e z. I. N., të cilat gjenden në Aneksin *** të dosjes së administruar nga ILDKPKI-ja. Për vitet 2013 dhe 2014, nga lëvizjet e llogarisë së pagës në “ProCredit Bank”, njoftuar me shkresën nr. *** prot., datë 2.12.2020, administruar në dosjen e Komisionit.

⁵² Të ardhura nga pensioni i prindërve sipas vërtetimeve nr. *** dhe nr. ***, datë 29.1.2021, nga ISSH-ja, dega Korçë; kontratë shitje pasurie datë 16.5.2005, dokumentet janë administruar nga Komisioni në përgjigje të pyetësorit nr. *** dhe nr. ***; kontratë kredie konsumatore nga “Raiffeisen Bank”, datë 21.9.2011, administruar në Aneksin *** të dosjes së ILDKPKI-së.

⁵³ Sipas shkresës nr. *** prot., datë 2.12.2020, të OTP Bank, administruar në dosjen e Komisionit.

⁵⁴ Shkresa nr. *** prot., datë 29.1.2019, e ILDKPKI-së.

⁵⁵ Nga fillimi i Shkollës së Magjistraturës dhe deri më 1.8.2015, për një person, vetëm për subjektin – nga gushti i vitit 2015 deri në tetor të vitit 2015, për dy persona, dhe pas datës 16.10.2015, kur lind djali, për tre persona.

⁵⁶ Shihni kontratat e paraqitura nga subjekti, të administruara në dosjen e Komisionit.

⁵⁷ Shihni vërtetimin datë 1.9.2020, nga kopshti jo publik “****” për vitet 2015 dhe 2016.

⁵⁸ Në vitin 2013 në “Raiffeisen Bank”, sipas shkresës nr. *** prot., datë 9.12.2020 dhe në vitin 2014 në “Tirana Bank”, sipas shkresës nr. *** prot., datë 9.12.2020.

⁵⁹ Shihni përgjigjet e bankave të nivelit të dytë të administruara në dosjen e Komisionit.

Rezultati financiar është i përlogaritur për çdo vit, për çdo datë/periudhë të kryerjes së transaksioneve të caktuara bankare, si dhe në total. Mundësia për kursime rezulton si diferencë e të ardhura – pasuri – shpenzime. Mundësia financiare është analizuar për çdo vit kalendarik.

B. KONTROLLI I FIGURËS

DSIK-ja ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikonte nëse subjekti ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016.

Për këtë qëllim, DSIK-ja ka dërguar raportin nr. *** prot., datë 31.10.2017, mbi kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, znj. Marsela A. Dervishi, i deklasifikuar plotësisht me vendimin nr. ***, datë 9.12.2020, të KDZH-së, nga ku rezulton se: (i) formulari i deklaramit është i plotë dhe i plotësuar në mënyrë të saktë në përputhje me përcaktimet ligjore të ligjit nr. 84/2016; (ii) ka pasur dhe ka të njëjtat gjeneralitete si ato të deklaruara nga subjekti në deklaratën për kontrollin e figurës; (iii) nuk administrohen prova, informacione konfidenciale apo informacione të tjera, nga të cilat mund të ngrihen dyshime të arsyeshme për implikimin e saj apo për kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar. Në konkluzion të këtij raporti, DSIK-ja ka konstatuar përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës të subjektit të rivlerësimit, znj. Marsela A. Dervishi.

Gjatë hetimit administrativ, me kërkesë të Komisionit, DSIK-ja ka kryer përditësimin e të dhënave, duke konfirmuar se nuk janë evidentuar elemente që cenojnë figurën e subjektit të rivlerësimit.

Në përfundim të procesit të rivlerësimit, nga Komisioni nuk u evidentuan fakte dhe rrethana që cenojnë figurën e subjektit të rivlerësimit apo kontakte me persona të përfshirë në krimin e organizuar, të cilat do të ndryshonin konstatimin fillestar të Grupit të Punës të DSIK-së, duke çmuar se subjekti i rivlerësimit, znj. Marsela Dervishi, është i përshtatshëm për vijimin e ushtrimit të detyrës, për shkak se ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, sipas parashikimit të germës “b”, të nenit 59/1, të ligjit nr. 84/2016.

C. RIVLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

Në zbatim të nenit 44 të ligjit nr. 84/2016 është bërë rivlerësimi profesional i subjektit të rivlerësimit, znj. Marsela Dervishi, bazuar në:

C/1. Raportin për aftësitë profesionale të subjektit të rivlerësimit, të kryer nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, dërguar me shkresën nr. *** prot., datë 12.1.2021, protokolluar nga Komisioni me nr. *** prot., datë 29.1.2021, nga ku rezultuan gjetjet si vijojnë:

1. Aftësitë profesionale

a) Njohuritë ligjore

Subjekti i rivlerësimit, znj. Marsela Dervishi, ka aftësi në drejtim të interpretimit dhe zbatimit të ligjit. Ajo identifikon normën ligjore të zbatueshme dhe jep arsye për mënyrën e zbatimit të saj në rastin konkret. Gjithashtu, gjyqtarja i kushton rëndësinë e duhur identifikimit të kërkimit të palëve, dëgjon kërkimet procedurale të tyre, shprehet në çdo rast me urdhra dhe vendime të ndërmjetme të arsyetuara. Ajo njeh parimet e përgjithshme të së drejtës dhe i zbaton gjatë gjykimit dhe sipas rastit i përdor shprehimisht në tekstin e vendimeve përfundimtare, si e drejta e një proces të rregullt ligjor, e drejta e mbrojtjes në procesin civil.

b) Arsyetimi ligjor

Subjekti Marsela Dervishi ka aftësi në arsyetimin ligjor. Përmbajtja e vendimit është gjithëpërfshirëse dhe i jepet përgjigje pretendimeve të palëve. Në tekstet e vendimit ekziston lidhja midis fakteve dhe konkluzioneve që ka arritur gjyqtarja. Në nxjerrjen e konkluzioneve i kushton rëndësi analizës së normës ligjore dhe në to nuk ka gabime logjike apo ligjore dhe sipas rastit e plotësuar me pjesë edhe nga jurisprudenca unifikuese e Gjykatës së Lartë, dispozitat kushtetuese, vendimet e Gjykatës Kushtetuese, konventat apo jurisprudenca e GJEDNJ-së. Niveli i arsyetimit të vendimeve ligjore të vëzhguara respekton standardin e procesit të rregullt ligjor.

2. Aftësitë organizative

a) Aftësia për të përballuar ngarkesën në punë

Në periudhën e rivlerësimit, subjekti ka gjykuar për një periudhë 2-vjeçare 8 çështje penale (krime dhe kundërvajtje), si dhe 193 çështje civile me palë kundërshtare, gjithsej 201 çështje. Rrjedhimisht, ngarkesa sasiore ka qenë nën standardin minimal, ndërkohë që në periudhën 3.9.2015 – 29.7.2016 ka qenë me leje lindjeje. Ajo respekton kohën në gjykim si element i rëndësishëm i procesit të rregullt ligjor dhe i ka gjykuar të gjitha çështjet brenda afateve standarde dhe ligjore të gjykimit, qofshin çështje civile apo administrative penale. Gjithashtu, ajo i ka kushtuar rëndësinë e duhur arsyetimit të vendimeve gjyqësore, duke respektuar afatet ligjore në të gjitha rastet e vëzhguara.

b) Aftësia për të kryer procedurat gjyqësore

Subjekti Marsela Dervishi ka aftësi për të kryer procedurat gjyqësore. Dosjet e vëzhguara janë vënë në lëvizje shpejt, përmes vendimeve formale për caktimin e seancës përgatitore apo gjyqësore. Ajo zhvillon dhe dokumenton procedurën e gjykimit gjatë drejtimit të procesit gjyqësor, duke ndjekur hapat që lidhen me çeljen e seancës, verifikimin e palëve me të drejtat dhe detyrimet procedurale, si dhe për prezantimin e gjykatës. Orienton drejt debatin dhe hetimin gjyqësor, marrjen e provave, kërkimet dhe prapësimet e palëve, diskutimin përfundimtar, deri në dhënien e vendimit përfundimtar.

c) Aftësia për të administruar dosjet

Për subjektin e rivlerësimit nuk janë konstatuar mangësi në aftësinë e saj për të administruar dosjet dhe për të mbikëqyrur saktësinë dhe plotësinë e akteve që përfshihen në të. Në dosje gjenden të gjitha aktet e procesit gjyqësor të zhvilluar, si shorti, kërkesëpapia apo kërkesa penale për gjykim, procesverbali i seancave përgatitore apo gjyqësore, vendimet e seancës përgatitore, gjyqësore, apo vendimet përfundimtare, fletëthirrjet, provat etj.

3. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale

a) Etika në punë

Nuk konstatohen të dhëna negative për etikën në punë të gjyqtarës Marsela Dervishi. Ndërkohë që nuk është paraqitur asnjë kërkesë për procedim disiplinor nga Ministria e Drejtësisë apo të jetë marrë ndonjë masë disiplinore nga ish-Këshilli i Lartë i Drejtësisë.

b) Integriteti

Për subjektin Marsela Dervishi nuk kanë dalë të dhëna në lidhje me imunitetin e saj ndaj çdo ndikimi apo presioni të jashtëm.

c) Paanësia

Nuk janë evidentuar raste të konfliktit të interesit të subjektit Marsela Dervishi. Ndërkohë që në asnjë prej dosjeve të vëzhguara nuk ka pasur kërkesa për përjashtimin e saj nga gjykimi i

çështjeve. Nga ana tjetër, nuk janë konstatuar raste që subjekti të mos ketë respektuar rregullat procedurale që lidhen me standardin e gjykatës së paanshme.

4. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional

a) Aftësitë e komunikimit

Subjekti Marsela Dervishi komunikon me etikë me palët ndërgjyqëse në gjykim. Ajo ka aftësi komunikuese me palët ndërgjyqëse, si gjatë veprimtarisë përgatitore, ashtu dhe asaj gjyqësore, ku shfaq sjellje etike, duke ruajtur paanësinë në gjykim dhe respektuar barazinë e palëve.

b) Aftësia për të bashkëpunuar

Nuk janë konstatuar të dhëna specifike mbi aftësinë e subjektit për të bashkëpunuar me kolegët dhe administratën gjyqësore, si dhe nëse subjekti ka shkëmbyer njohuri apo përvojë profesionale me ta. Subjekti e ka realizuar arsyetimin e vendimeve brenda afateve ligjore dhe në afate të shpejta, çka tregon se bashkëpunimi i saj me administratën gjyqësore në këtë drejtim ka qenë në nivelin e duhur.

c) Gatishmëria për t'u angazhuar

Në periudhën e rivlerësimit ajo ka marrë pjesë në 18 trajnime të organizuar nga Shkolla e Magjistraturës, ndërkohe që ka marrë pjesë dhe është certifikuar në 2 trajnime jashtë programit të Shkollës së Magjistraturës, të cilat janë jashtë periudhës së rivlerësimit. Subjekti ka qenë bashkautore në shkrime të ndryshme.

C/2. Informacioni i marrë nga burime të ligjshme, ku si të tilla janë konsideruar:

1. Informacioni i marrë nga tri vendimet e përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit dhe pesë çështjet e shortuara sipas nenit 43 të ligjit nr. 84/2016, nga analiza e të cilave nga Komisioni rezultuan gjetje të evidentuara edhe nga Këshilli i Lartë Gjyqësor në raportin e tij.

2. Informacioni i marrë nga 5 denoncime nga publiku, të administruara nga Komisioni, pas verifikimit të të cilave në 3 prej tyre u konstatua se denoncuesit denonconin subjektin e rivlerësimit për vendimmarrje të padrejtë⁶⁰, pretendime të cilat lidhen me themelin e çështjes dhe korrektësinë e vendimit dhe, si të tilla, janë objekt gjykimi nga një gjykatë më e lartë. Në këtë kuptim, bazuar në pikën 4, të nenit 72, të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, nuk është në kompetencën e Komisionit vlerësimi i pretendimeve të tilla. Ndërsa, Komisioni vendosi të thellojë hetimin administrativ në lidhje me pretendimet e ngritura në dy denoncimet, si vijojnë:

Denoncim nga shtetasi F. M.⁶¹

Në denoncimin e tij ky shtetas ngrinte disa pretendime: (1) gjyqtarja Marsela Dervishi, në gjykimin e çështjes nr. ***, nuk kishte kryer verifikimin e afatit procedural të ankimit të shtetasit M. K. ndaj vendimit të mosfillimit të procedimit penal, i cili ishte depozituar në sekretarinë gjyqësore në datën 22.12.2017, ndërkohe që vendimi i organit procedues i ishte njoftuar ankuesit M. K. në datën 15.7.2017, vërtetuar me informacionin mbi çështjen e printuar nga faqja zyrtare e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier; (2) gjyqtarja kishte interpretuar në mënyrë të gabuar provat dhe faktet; si dhe (3) kishte shtyrje pa shkaqe të seancave gjyqësore.

2.1. Në lidhje me pretendimin e parë:

Gjatë hetimit administrativ, me qëllim verifikimin e pretendimit për mosllogaritjen e afatit procedural të ankimit, nga Komisioni u administrua dosja gjyqësore e çështjes së Gjykatës së

⁶⁰ Shihni denoncimin nga shtetasi Th. C., përcjellë nga komisionerët publikë, protokolluar nga Komisioni me nr. *** prot., datë 25.9.2019 dhe nr. *** prot., datë 1.10.2019, në dosjen e Komisionit.

⁶¹ Shihni denoncimin nga shtetasi F. M., protokolluar me nr. *** prot., datë 24.10.2018, në dosjen e Komisionit.

Rrethit Gjyqësor Fier⁶², nga aktet e së cilës u konstatua se: (i) me vendimin e datës 15.7.2017, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier ka vendosur mosfillimin e procedimit penal për kallëzimin me nr. ***, të vitit 2016, të kallëzuesit M. K. etj., duke njohur palët edhe me të drejtën e ankimit brenda 5 ditëve; (ii) me shkresën nr. *** prot., datë 9.10.2017, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier i ka përcjellë kallëzuesit vendimin për mosfillimin e procedimit penal; (iii) vendimi i është komunikuar shtetasit M. K. nëpërmjet shërbimit postar, në datën 11.10.2017, por për shkak të adresës jo të saktë, zarfi është kthyer në prokurori dhe është tërhequr në datën 18.12.2017, pa u përcaktuar nga kush është tërhequr; (iv) ndaj vendimit të mosfillimit të procedimit penal ka paraqitur ankim shtetasi M. K., i cili është regjistruar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier në datën 22.12.2017; (v) në datën 5.2.2018 gjyqtarja Marsela Dervishi ka paraqitur kërkesën për heqjen dorë nga gjykimi i kësaj çështjeje, kërkesë e cila nuk është pranuar nga kryetari i gjykatës; (vi) me vendimin nr. ***, datë 6.3.2018, gjyqtarja Marsela Dervishi ka vendosur pranimin e ankimit.

Për sa i takon pretendimit të denoncuesit se gjyqtarja Marsela Dervishi nuk ka kryer verifikimin e afatit procedural të ankimit të shtetasit M. K., referuar pikës 2, të nenit 291 të Kodit të Procedurës Penale, vërehet se afati i ankimit të palëve në gjykatë është brenda 5 ditëve nga data e njoftimit të vendimit. Për të përcaktuar datën e njoftimit të vendimit, datë nga e cila fillon afati 5-ditor, nga verifikimi i akteve në dosje nuk u gjend ndonjë dëftesë komunikimi, por u konstatua se ky vendim i ishte përcjellë shtetasit M. K. nëpërmjet shërbimit postar, i cili për shkak të adresës jo të saktë nuk ka mundur ta gjejë marrësin dhe për këtë arsye ia ka kthyer zarfin organit procedues. Zarfi i kthyer është tërhequr në datën 18.12.2017, fakt i evidentuar vetëm nga nënshkrimi mbi zarf i kryesekretares së Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier.

Për të saktësuar datën e marrjes dijeni të vendimit të mosfillimit nga shtetasi M. K., gjatë procesit të rivlerësimit subjektivit iu kërkua të japë sqarime mbi llogaritjen e afatit procedural për pranimin e ankimit, duke vërtetuar me dokumente datën e marrjes dijeni. Në përgjigjet e pyetësorit nr. 4, subjekti ka sqaruar se gjykata ka verifikuar në mënyrë të qartë dhe me prova afatin e ankimit, duke konkluduar se ankimi është paraqitur brenda afatit 5-ditor, duke mbajtur në konsideratë këto fakte:

- Organi i prokurorisë nuk ka provuar se ka kryer një njoftim efektiv të kallëzuesit në lidhje me vendimin e mosfillimit, pasi zarfi i dërguar në adresë të tij është kthyer i pakonfirmuar. Por, sipas subjektivit zarfi mban nr. prot. ***, i cili është edhe numri i protokollit të shkresës shoqëruese të njoftimit të vendimit, si dhe mbi të është shënuar emri i kallëzuesit M. K., duke u provuar kështu plotësisht fakti që zarfi i paraqitur si provë i përket pikërisht njoftimit të ankuesit në lidhje me vendimin e mosfillimit, objekt ankimi.

- Ky zarf është tërhequr në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier në datën 18.12.2017, fakt që konfirmohet edhe nga shënimi i kryesekretares së prokurorisë, shoqëruar me vulën e institucionit. Në këto kushte, gjykata ka vlerësuar se data e vetme në të cilën konfirmohet dijenia e ankuesit është data 18.12.2017, pasi nuk ka asnjë provë për dijeninë e tij para kësaj date. Për sa i përket mospasqyrimin në shënimin e kryesekretares së personit që ka tërhequr zarfin, kam vlerësuar se ky nuk përbën fakt të rëndësishëm për gjykatën për tri arsye kryesore:

1- Zarfi mban emrin e shtetasit M. K. dhe prezumohet se kryesekretarja ia ka dorëzuar këtij personi, pasi si rregull nuk mund t'i dorëzohet në emër të një personi konkret, dikujt tjetër.

⁶² Shihni shkresën kthim përgjigje nr. *** prot., datë 8.2.2021, nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier, në dosjen e Komisionit.

2 - Ky zarf është paraqitur si provë nga vetë ankuesi M. K., fakt që konfirmon edhe tërheqjen e tij nga ana e këtij të fundit.

3 - Ankimi është paraqitur brenda afatit 5-ditor nga dita e tërheqjes së zarfit. Për këtë arsye, pavarësisht personit konkret që mund të ketë tërhequr zarfin, ankimi është paraqitur brenda afatit 5-ditor nga data konkrete e tërheqjes së tij në prokurori (që përfaqëson datën e vetme të vërtetuar) dhe, për rrjedhojë, nuk ka vend për të diskutuar faktin nëse zarfi mund të jetë tërhequr nga dikush tjetër. Në këto kushte, bazuar në provën e paraqitur nga vetë ankuesi, gjykata ka vlerësuar se ky i fundit është vënë në dijeni të vendimit të mosfillimit, në datën 18.12.2017.

Pavarësisht sqarimeve të dhëna gjatë procesit të rivlerësimit si më sipër, duke qenë se nuk u arrit të provohej data e marrjes dijeni personalisht nga shtetasi M. K., me njoftimin e rezultateve të hetimit, subjektit iu kërkua të paraqesë faqen e regjistrit të protokollit të prokurorisë me nënshkrimin e shtetasit M. K. për marrjen e zarfit.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit dhe vlerësimi i Komisionit

Në parashtrimet e tij, subjekti sqaroi se pas kërkesës drejtuar Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, ky institucion ka informuar se: “... në datën 18.12.2017 shtetasi M. K. është paraqitur në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për të tërhequr zarfin e kthyer nga Zyra Postare Fier. Sipas praktikës së prokurorisë për zarfat e kthyer nga shërbimi postar, kur dokumenti tërhiqet pranë këtij institucioni, marrësi nënshkruan te fotokopja e zarfit të kthyer, emër, mbiemër, firmë dhe datën e marrjes së zarfit, akt i cili arkivohet në dosjen përkatëse. Për rastin në fjalë, shtetasi M. K. i është dorëzuar personalisht zarfi kundrejt nënshkrimit, duke dërguar një kopje të dokumentit të nënshkruar nga shtetasi M. K.”. Në këto kushte, sipas saj pretendimi i ankuesit F. M. për mosverifikimin e afatit të ankimit është i pabazuar.

Nga verifikimi i kopjes së zarfit të paraqitur nga subjekti, dërguar nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Fier, u konstatua se mbi të gjendet shënimi i marrjes së vendimit, në datën 18.12.2017 nga shtetasi M. K. dhe nënshkruar prej tij. Në kushtet kur nga subjektit u vërtetua se shtetasi M. K. ka marrë dijeni për vendimin e mosfillimit në datën 18.12.2017, pretendimi i tij se gjyqtarja Marsela Dervishi nuk ka kryer verifikimin e afatit procedural të ankimit, vlerësohet se nuk qëndron.

2.2. Në lidhje me pretendimin e dytë:

Nga denoncuesi pretendohet se vendimi nr. ***, datë 6.3.2018, i gjyqtares Marsela Dervishi, në të cilin i kërkohet prokurorisë të realizojë nga e para çdo veprim hetimor, favorizon palën ankuese dhe se gjyqtarja qëllimisht ka modifikuar dhe interpretuar të shtrembëruara faktet dhe provat në dosjen gjyqësore. Komisioni vlerëson se ky pretendim ka të bëjë me vendimmarrjen dhe bindjen e brendshme të gjyqtarit, të cilat janë jashtë tagrit të tij si organ rivlerësimi, i cili në çdo rast nuk mund të zëvendësojë interpretimin ose logjikën e gjyqtarit, sipas nenit 72 të ligjit nr. 96/2016.

2.3. Në lidhje me pretendimin e tretë:

Nga denoncuesi pretendohet se seancat gjyqësore të drejtuara nga gjyqtarja Marsela Dervishi ato janë shtyrë për motive të pakuptimta. Me qëllim vlerësimit të këtij pretendimi, nga ana e Komisionit u këqyrën aktet e dosjes gjyqësore të çështjes, nga ku u konstatua se janë zhvilluar gjithsej 6 seanca gjyqësore, përkatësisht në datat 22.1.2018, 5.2.2018, 8.2.2018, 19.2.2018, 26.2.2018 dhe 6.3.2018, në caktimin e të cilave është respektuar në çdo rast afati 15-ditor. Ndërkohë që, sa i takon kohëzgjatjes së gjykimit të çështjes, u konstatua se çështja është regjistruar në gjykatë në datën 22.12.2017 dhe ka përfunduar më 6.3.2018, duke zgjatur 2 muaj

e 14 ditë, pra, në tejkalim të afatit 30-ditor të parashikuar në pikën 3, të nenit 291, të Kodit të Procedurës Penale.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit dhe vlerësimi i Komisionit

Me njoftimin e rezultateve të hetimit subjektit iu kërkuan sqarime në lidhje me këtë konstatim, e cila, në parashtrimet e saj sqaroi se çështja është regjistruar në fund të vitit kalendarik dhe, për rrjedhojë, ky fakt ka diktuar në mënyrë të detyrueshme caktimin e seancës së parë gjyqësore në fillim të vitit pasardhës, ndërkohë që në dy javët e para të muajit janar nuk caktohen seanca gjyqësore për shkak të procesit administrativ të mbartjes së dosjeve. Sipas saj, arsyet e shtyrjes së seancave gjyqësore vinë për shkaqe objektive që lidhen me sjelljen e palëve, si vijojnë: pretendimet e ankuesit M. K. mbi paanësinë e gjykatës; kërkesa e prokurorit për vazhdimin e përfaqësimit nga prokurori që kishte dhënë vendimin e mosfillimit; kërkesë e ankuesit për përgatitjen e qëndrimit me shkrim; kërkesë e prokurorit për të paraqitur aktet e fashikullit.

Gjithashtu, ajo ka sjellë në vëmendje të Komisionit vendimin nr. 5, datë 12.12.2013, të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, sipas të cilit: *“...pavarësisht afateve të parashikuara në ligjet tona procedurale, qofshin ato civile dhe penale, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë vlerësojnë dhe janë të ndërgjegjshme se jo gjithmonë këto afate mund të zbatohen me rigorozitet nga ana e gjyqtarëve gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre dhe jo gjithmonë mosrespektimi i tyre është shkak ligjor për marrjen e masave disiplinore ndaj gjyqtarëve nga ana e KLD-së. Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë vlerësojnë se pamundësia për të respektuar maksimalisht këto dispozita mund të justifikohet nga ekzistenca e shkaqeve objektive, të cilat nuk varen nga gjyqtarët dhe që mund t'i pengojnë në respektimin rigoroz të këtyre normave, siç mund të jenë: ngarkesa e madhe në punë, kompleksiteti i çështjeve në ngarkim, sjellja e palëve gjatë procesit, pamundësia objektive e gjykatave për zhvillimin e procesit gjyqësor, shkaqe të justifikuara shëndetësore apo familjare, të cilat mund të kenë ndikim direkt tek gjyqtari dhe nuk e lejojnë atë të ushtrojë detyrën e tij, etj.”*

Në vlerësim të parashtrimeve të subjektit dhe referuar procesverbaleve të seancave gjyqësore, në përfundim Komisioni i vlerësoi bindëse shpjegimet e subjektit dhe pavarësisht tejkalimit të afatit ligjor 30-ditor të gjykimit, nuk evidentoi elemente që cenojnë procesin e rregullt ligjor apo aftësitë profesionale të saj.

Denoncim nga shtetasja I. B.⁶³

Në denoncimin e saj kjo shtetase informonte se pas ankesës për gjyqtaren Marsela Dervishi, KLD-ja, me vendimin e datës 30.7.2018, kishte vendosur fillimin e hetimit disiplinor.

Gjatë hetimit administrativ, me qëllim verifikimin e këtij pretendimi, Komisioni administroi nga KLGJ-ja praktikë-ankesën me nr. *** prot., datë 30.11.2017, të shtetasës I. B., nga aktet e së cilës u konstatua se:

- në ankesën e saj shtetasja I. B. ngrinte pretendime për zvarritje të gjykimit nga gjyqtarja Marsela Dervishi në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier, lidhur me çështjen që i përkiste babait të saj, i cili kishte ndërruar jetë në spital dhe se mjekët që e pritën janë akuzuar për veprën penale “mjekim të pakujdesshëm”;

- me vendimin nr. *** prot., datë 18.5.2018, KLD-ja vendosi verifikimin e ankesës, duke i kërkuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier kopjen e akteve të çështjes gjyqësore, si data e shortimit, data e regjistrimit të çështjes, procesverbalet e seancave gjyqësore, si dhe të merren shpjegime nga gjyqtarja apo persona që kanë dijeni;

⁶³ Shihni denoncimin nga shtetasja I. B., protokolluar nga Komisioni me nr. *** prot., datë 24.12.2018, në dosjen e Komisionit.

- pas verifikimit të ankesës, nga ana e inspektorëve të KLD-së u konstatua se: (i) në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier është regjistruar çështja penale nr. ***, datë 1.9.2016, që i përket Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Fier kundër të pandehurve B. F., J. S., H. H. dhe L. D., të akuzuar për veprën penale “mjekim të pakujdesshëm”; (ii) me shortin e datës 1.9.2016, kjo çështje penale i është caktuar gjyqtarës Marsela Dervishi; (iii) kohëzgjatja e gjykimit deri më 22.5.2018 është 1 vit, 8 muaj e 21 ditë, në tejkallim të dukshëm të afatit standard 9-mujor të përcaktuar për këtë kategori çështjesh penale të përcaktuar nga germa “a” e pikës 5, të Aneksit 1, të Sistemit të Vlerësimit; (iv) janë caktuar 41 seanca gjyqësore dhe në caktimin e tyre përgjithësisht është respektuar afati 15-ditor, por nuk mungojnë rastet kur ky afat është shkelur dhe shtyrja e tyre jo gjithmonë është e justifikuar;

- me vendimin nr. *** prot., datë 30.7.2018, KLD-ja vendosi fillimin e hetimit disiplinor ndaj gjyqtarës Marsela Dervishi, për zvarritje të gjykimit në lidhje me procesin ku është palë ankuesja I. B.. Gjatë procedurës hetimore, nga gjyqtarja Marsela Dervishi është paraqitur në datën 12.9.2018 një parashtrësë në lidhje me vendimin e KLD-së për nisjen e procedurës disiplinore, në të cilën ajo ka dhënë shpjegime të detajuara mbi gjetjet e konstatuara nga ky institucion lidhur me shkaqet e shtyrjes së seancave gjyqësore dhe kohëzgjatjen e gjykimit, duke i lidhur me kompleksitetin e çështjes, sjelljen e palëve dhe autoriteteve në proces, ngarkesën e punës, etj.

- në përfundim të hetimeve të kryera dhe provave të mbledhura nga inspektorët e KLD-së, rezultoi se: (i) me vendimin nr. ***, datë 29.5.2018, ka përfunduar gjykimi i çështjes penale nr. ***, duke u vendosur: *Deklarimi fajtor i të pandehurës L. D. për veprën penale të parashikuar nga neni 96/1 i Kodit Penal dhe dënimin e saj me 6 muaj burgim. Aplikimin e nenit 59 të Kodit Penal, pezullimin e dënimit me burgim dhe vënien në provë për një afat 1 vit, si heqja e të drejtës së ushtrimit të një profesioni apo veprimtarie për një periudhë 2-vjeçare. Deklarimin e pafajshëm të të pandehurve të tjerë ...*; (ii) ndaj këtij vendimi është ushtruar ankim në Gjykatën e Apelit Vlorë në datën 9.7.2018 dhe me shortin e datës 10.7.2018 i ka kaluar për gjykim gjyqtarit relator S. N.; (iii) deri në datën e kryerjes së verifikimit nga ILD-ja, 18.10.2018, kjo çështje nuk ishte planifikuar për gjykim;

- me vendimin nr. *** prot., datë 13.12.2018, ILD-ja, bazuar në propozimin e inspektorëve në përfundim të hetimeve, vendosi pezullimin e hetimit disiplinor ndaj gjyqtarës Marsela Dervishi, deri në dhënien e vendimit të formës së prerë, duke i kërkuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier dërgimin e menjëhershëm në ILD të çdo vendimi që do të merret nga gjykatat më të larta.

Duke qenë se nga aktet e vëna në dispozicion nga KLGJ-ja nuk u gjet informacion në lidhje me ecurinë e këtij procedimi disiplinor dhe nëse vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier kishte marrë formë të prerë, pas verifikimit në faqen zyrtare të Gjykatës së Apelit Vlorë u konstatua se vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier nuk ka marrë formë të prerë, pasi çështja është me status në përpunim.

Në përfundim të hetimit administrativ, pas verifikimit të akteve të paraqitura nga KLGJ-ja lidhur me datën e shortimit, datën e regjistrimit të çështjes, si dhe procesverbaleve të seancave gjyqësore, Komisioni konstatoi se kohëzgjatja e gjykimit të çështjes ka qenë 1 vit, 8 muaj e 27 ditë, në tejkallim të afatit standard 9-mujor të përcaktuar për këtë kategori çështjesh penale të përcaktuar nga germa “a”, e pikës 5, të Aneksit 1, të Sistemit të Vlerësimit.

Me njoftimin e rezultateve të hetimit subjektivit iu kërkuar të japë sqarime në lidhje me këtë konstatim, e cila në parashtrimet e tij ka dhënë shpjegime të detajuara, duke paraqitur argumente për shkaqet objektive të tejkallimit të afatit ligjor 9-mujor të gjykimit të çështjes. Pavarësisht këtyre shpjegimeve, në përfundim të procesit Komisioni çmoi se tejkallimi i afatit

ligjor nuk duhet parë vetëm si kohëzgjatje në kuptimin sasior, por edhe në vlerësim të shkaqeve për të cilat janë shtyrë seancat gjyqësore⁶⁴, vlerësim i cili është ende në proces nga organi kompetent. Ndërsa, në kuadër të procesit të rivlerësimit të aftësive profesionale të subjektit, është fakt që problematikat e evidentuara nga KLGJ-ja deri në momentin e pezullimit të procesit disiplinor i përkasin një rasti të vetëm.

Në këto kushte, duke mbajtur në konsideratë rrethanat e çështjes, si dhe konstatimet dhe vlerësimet pozitive të aftësive profesionale të subjektit, në përfundim të procesit Komisioni vlerësoi se ky rast nuk është i mjaftueshëm për ta klasifikuar subjektin e rivlerësimit me “mangësi profesionale”, sipas pikës b, të nenit 44, të ligjit nr. 84/2016, referuar edhe opinionit CDL-AD (2016)036 të Komisionit të Venecias si dhe vendimit nr. 2, datë 18.1.2017, të Gjykatës Kushtetuese, të cilat kanë vendosur qartë kufirin ndarës për një vlerësim negativ të aftësive profesionale, i cili bëhet vetëm në rastet e gabimeve thelbësore dhe serioze dhe/ose kur ekziston një seri e qartë dhe e vazhdueshme e gjykimeve të gabuara që tregojnë mungesë të aftësive profesionale. Për më tepër, në zbatim të pikës 1, të nenit 42 dhe nenit 43 të ligjit nr. 84/2016, si dhe nenit 77 të ligjit nr. 96/2016, vlerësimi përfundimtar lidhur me secilin prej kriterëve të vlerësimit të aftësive profesionale të magjistratit, duhet të jetë produkt i vlerësimit tërësor të burimeve të përcaktuara në ligj dhe jo i bazuar në një burim të vetëm vlerësimi e aq më pak të një çështjeje të vetme⁶⁵.

3. Informacioni i marrë nga KLGJ-ja, etj., lidhur me ankesa, kallëzime apo masa disiplinore, nga ku për subjektin e rivlerësimit, znj. Marsela Dervishi, përgjatë periudhës së rivlerësimit rezultoi se:

- Nuk është paraqitur asnjë kërkesë për procedim disiplinor nga Ministria e Drejtësisë apo të jetë marrë ndonjë masë disiplinore nga ish-Këshilli i Lartë i Drejtësisë.

- Janë paraqitur gjithsej 2 ankesa (1 në vitin 2014 dhe 1 në vitin 2015) në Inspektoratin e ish-KLD-së. Ankesa e vitit 2015 është arkivuar pas shqyrtimit fillestar me arsyetimin se nuk ka fakte dhe rrethana të vlefshme për verifikim. Ndërsa ankesa e vitit 2014 është verifikuar për zvarritje gjykimi dhe është vendosur tërheqja e vëmendjes me shkrim për efekt vlerësimi etik dhe profesional gjyqtarës Marsela Dervishi. Në lidhje me këtë ankesë, gjatë hetimit administrativ Komisioni administroi⁶⁶ praktikën dhe ankesën nr. *** prot., datë 30.5.2014, që i përkiste shtetasës N. B., nga aktet e së cilës u konstatua se:

- në datën 14.5.2014 shtetasja N. B. kishte paraqitur një ankesë pranë Institucionit të Presidentit, përcjellë për kompetencë ish-KLD-së, në të cilën ngrinte pretendime për zvarritje të gjykimit nga gjyqtarë të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, në çështjen civile që i përket paditësit S. B. (bashkëshorti i znj. N. B.), me objekt “Deklarimin pjesërisht të pavlefshëm të titullit ekzekutiv nr. ***, datë 5.2.2010, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier. Vendosjen e masës së pezullimit për ekzekutimin e vendimit përmbarimor”;

- nga aktet e administruara nga ish-KLD-ja gjatë trajtimit të ankesës lidhur me çështjen e kësaj shtetaseje, rezultoi se: (i) çështja është hedhur në short në datën 11.4.2014, dhe i ka rënë për gjykim gjyqtarës Marsela Dervishi; (ii) për çështjen janë zhvilluar gjithsej 7 seanca gjyqësore, përkatësisht në datat 22.4.2014, 13.5.2014, 26.5.2014, 18.6.2014, 2.7.2014, 17.7.2014 dhe 9.9.2014; (iii) gjykimi i çështjes nga data e shortit 11.4.2014, dhe deri në datën e verifikimit 3.9.2014, ka zgjatur 4 muaj e 22 ditë, ndërkohë që gjykimi ka përfunduar në datën 9.9.2014,

⁶⁴ Vendimi nr. 69, datë 17.11.2015 dhe vendimit nr.1, datë 21.1.2016 i Gjykatës Kushtetuese, parashikojne se “kohëzgjatja e arsyeshme e procesit gjyqësor, duhet të vlerësohet nën dritën e rrethanave të çështjes, duke marrë në konsideratë kompleksitetin e çështjes, sjelljen dhe interesin e kërkuarit, dhe autoriteteve përkatëse”.

⁶⁵ Shih vendimin e KPA, Nr. 11 regjistër (JR) Nr. 25 i vendimit, datë 01.10.2020, paragrafi nr.114.

⁶⁶ Shihni shkresën kthim përgjigje nr. *** prot., datë 8.2.2021, nga KLGJ-ja, në dosjen e Komisionit.

pra, brenda afatit 6-mujor të parashikuar për këtë kategori çështjes sipas vendimit të KLD-së “Mbi kriteret matëse të veprimtarisë gjyqësore”; (iv) lidhur me kërkesën për vendosjen e masës së pezullimit për ekzekutimin e vendimit përmbarimor rezultoi se gjyqtarja nuk e ka marrë në shqyrtim këtë kërkesë brenda afatit 5-ditor nga data e shortit, sipas nenit 609/4 të Kodit të Procedurës Civile;

- në përfundim të verifikimit të çështjes, nga KLD-ja kjo çështje është vlerësuar e vetme, e nivelit formal dhe e pamjaftueshme për t’u klasifikuar si shkelje me pasojë përgjegjësinë disiplinore dhe, si e tillë, bazuar në nenin 34/2 të rregullores së Inspektoratit të KLD-së është vendosur që gjyqtarës Marsela Dervishi t’i tërhiqet vëmendja me shkrim.

Në përfundim të hetimit administrativ, pas verifikimit të akteve, nga Komisioni u konstatua se subjekti në shqyrtimin e çështjes ka tejkaluar afatin 5-ditor për shqyrtimin e kërkesës për vendosjen e masës së pezullimit për ekzekutimin e vendimit përmbarimor, sipas nenit 609/4 të Kodit të Procedurës Civile, sipas të cilit gjykata shqyrton kërkesat sipas këtij neni, brenda 5 ditëve nga data e hedhjes së shortit.

Me njoftimin e rezultateve të hetimit, subjektin iu kërkua të japë sqarime në lidhje me këtë konstatim.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit dhe vlerësimi i Komisionit

Subjekti, në parashtrimet e saj, ka sqaruar se:

Së pari, ajo nuk është vënë në dijeni nga Inspektorati i KLD-së me rezultatet e përfundimit të verifikimit, si dhe me tërheqjen e vëmendjes me shkrim, dhe kjo sipas saj vërtetohet me mungesën e ndonjë akti njoftimi në praktikën e ankesës së administruar nga Komisioni, por i vetmi akt që i është njoftuar është aktinjoftimi i datës 3.9.2014, ku i është bërë me dije urdhri për verifikimin e ankesës së shtetasës N. B..

Në lidhje me pretendimin e subjektit se nuk është vënë në dijeni nga KLD-ja mbi rezultatet e verifikimit të ankesës dhe tërheqjen e vëmendjes me shkrim, nga aktet e praktikë-ankesës së paraqitur nga KLGj-ja konstatohet se në të gjendet një shkresë pa numër protokolli, pa datë dhe pa nënshkrimin e zëvendëskryetarit drejtuar gjyqtarës Marsela Dervishi. Fakti i tërheqjes së vëmendjes së gjyqtarës i është njoftuar vetëm ankueses N. B., me shkresën nr. *** prot., datë 31.12.2014.

Së dyti, në lidhje me mosrespektimin e afatit 5-ditor për shqyrtimin e kërkesës së masës së sigurimit, ka sqaruar se ka qenë në kushtet e pamundësisë objektive të respektimit të këtij afati, pasi kërkesëpadia është depozituar në gjykatë në datën 11.4.2014, ndërkohë që çështja është regjistruar në regjistër dhe në sistem në datën 14.4.2014. Kurse, sipas subjektit, çështja është shortuar në datën 15.4.2014, në orën 15:52:11 dhe i është caktuar për gjykim asaj, pra gjyqtarës Marsela Dervishi, e cila e ka marrë në dorëzim më 16.4.2014, vërtetuar me regjistrin e veprimeve të printuar nga sistemi i gjykatës. Pra, në rastin konkret, ajo ka qenë në kushtet e pamundësisë objektive të respektimit të afatit 5-ditor, për arsye se dosja i është vënë në dispozicion pasi kishte kaluar ky afat, në datën 16.4.2014, ne kushtet kur çështja i është nënshtruar procedurave të shortit të zakonshëm. Gjithashtu, subjekti ka sqaruar se prej saj janë bërë përpjekje maksimale për të vënë në lëvizje sa më shpejt çështjen, si: caktimi i seancës përgatitore që në datën e marrjes së dosjes, caktimi i një seance gjyqësore brenda 5 ditëve nga data e marrjes së dosjes si dhe njoftimet për palët. Për të mbështetur pretendimet e saj, subjekti ka paraqitur si provë aktet e dosjes civile që i përket çështjes nr. ***, datë 14.4.2014.

Nga sqarimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit dhe aktet e dosjes civile të paraqitura prej saj, lidhur me tejkalimin e afatit 5-ditor, është vërtetuar se:

i) kërkesëpadi është paraqitur në gjykatë në datën 11.4.2014 dhe është regjistruar në regjistër dhe në sistem më 14.4.2014, vërtetuar me shënimin e kryesekretarisë të bërë në kërkesëpadi dhe datën e regjistrimit të shënuar në kapakun e dosjes, nga ku rezulton se numri i aktit *** i përket datës 14.4.2014;

ii) çështja është shortuar në datën 15.4.2014, në orën 15:52:11 dhe i është caktuar për gjykim gjyqtarës Marsela Dervishi dhe jo në datën 11.4.2014, siç është referuar në raportin e inspektorëve të KLD-së, vërtetuar me regjistrin e veprimeve të printuar nga sistemi i gjykatës;

iii) dosja i është dorëzuar gjyqtarës Marsela Dervishi në datën 16.4.2014, vërtetuar me regjistrin e veprimeve të printuar nga sistemi i gjykatës;

iv) subjekti ka ndërmarrë veprime të shpejta lidhur me çështjen, si: ka nxjerrë vendimin e caktimit të seancës përgatitore në datën që ka marrë dosjen, 16.4.2014; ka caktuar një seancë gjyqësore brenda 5 ditëve nga data e marrjes së dosjes, 22.4.14; ka bere njoftimet e palëve më 16.4.14.

Bazuar në sa më sipër, rezultoi se janë vërtetuar disa shkaqe objektive, të cilat kanë diktuar tejkalimin e afatit procedural 5-ditor për shqyrtimin e kërkesës për pezullimin e vendimit përmbarrimor, dhe për këtë arsye, dosja është marrë në dorëzim nga subjekti jashtë këtij afati, fakt i dokumentuar nga subjekti në ushtrim të barrës së provës. Nga ana tjetër, subjekti u vertetua qe ka ndërmarrë veprime të shpejta për të vënë në lëvizje çështjen. Për rrjedhojë, në përfundim të procesit nuk janë evidentuar problematika që cenojnë aftësitë profesionale të subjektit të rivlerësimit.

C/3. Rivlerësimi profesional sipas kritereve të parashikuara në nenin 71 e vijues të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”

Në përfundim të procesit të rivlerësimit të aftësive profesionale, sipas kritereve të parashikuara në kreun II të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në zbatim të pikës 2, të nenit E, të Aneksit të Kushtetutës, Komisioni vlerësoi se:

- subjekti i rivlerësimit ka treguar aftësi të mira profesionale, sipas nenit 73 të ligjit nr. 96/2016;
- subjekti i rivlerësimit ka treguar aftësi të mira organizative, sipas nenit 74 të ligjit nr. 96/2016;
- subjekti i rivlerësimit ka treguar aftësi personale dhe angazhim profesional, sipas nenit 76 të ligjit nr. 96/2016;
- subjekti i rivlerësimit ka treguar etikë të lartë dhe angazhim ndaj vlerave profesionale, parashikuar nga neni 75 i ligjit nr. 96/2016.

Për sa më sipër, sipas germës “a”, të nenit 44, të ligjit nr. 84/2016, me propozim të relatores së çështjes, subjekti i rivlerësimit është vlerësuar “i aftë” profesionalisht, për shkak se ka arritur nivelin kualifikues për vlerësimin e aftësive profesionale, sipas parashikimit të germës “c”, të pikës 1, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016.

III. SEANCA DËGJIMORE

Në datën 23.3.2021, sipas nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, u zhvillua seanca dëgjimore për procedurën e rivlerësimit kalimtar të subjektit të rivlerësimit, znj. Marsela Dervishi, në përfundim të së cilës kërkoi konfirmimin në detyrë.

Në përfundim të procesit të rivlerësimit, trupi gjykues i Komisionit, pasi dëgjoji relatoren e çështjes, komisionere Firdes Shuli, e cila rekomandoi konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit dhe pasi administroi dokumentet shkresore, përfundoi procedurën e rivlerësimit

kalimtar për subjektin e rivlerësimit, znj. Marsela Dervishi, dhe shpalli këtë vendim në datën 25.3.2021, sipas pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.

IV. QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

Gjatë procesit të rivlerësimit, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave, si dhe krijimin e bindjes së brendshme, trupi gjykues ka komunikuar me anë të postës elektronike me subjektin e rivlerësimit, sipas nenit 46 të ligjit nr. 84/2016.

Në të gjitha komunikimet, subjekti ka qenë në çdo rast i gatshëm, duke u treguar tërësisht bashkëpunues, pasi i është përgjigjur me korrektesë dhe brenda afateve të caktuara të gjitha pyetjeve, duke filluar me pyetësonin standard, ku ka dhënë shpjegime të detajuara dhe ka paraqitur dokumente shkresore dhe duke vijuar me procesin e rivlerësimit duke dhënë shpjegime në mënyrë shteruese për informacionin e kërkuar, bazuar në dokumente shkresore

për të vërtetuar, për sa i është kërkuar nga Komisioni, qëndrim i cili është mbajtur në konsideratë gjatë procesit të vendimmarrjes, sipas parashikimit të nenit 48 të ligjit nr. 84/2016.

KONKLuzion PËRFUNDIMTAR

Bazuar në parimet e barazisë përpara ligjit, të kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë, si dhe në parimin e proporcionalitetit, sipas pikës 5, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016, në përfundim të procesit të rivlerësimit, Komisioni krijoi bindjen se:

1. Referuar nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe kreut IV të ligjit nr. 84/2016, lidhur me kriterin e pasurisë, subjekti i rivlerësimit, znj. Marsela Dervishi, ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, sipas nenit 59/a të ligjit.
2. Referuar nenit DH të Aneksit të Kushtetutës dhe kreut V të ligjit nr. 84/2016, lidhur me kriterin e pastërtisë së figurës, subjekti i rivlerësimit, znj. Marsela Dervishi, ka arritur nivel të besueshëm për kontrollin e figurës, sipas nenit 59/b të ligjit.
3. Referuar nenit E të Aneksit të Kushtetutës dhe kreut VI të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit, znj. Marsela Dervishi, ka arritur nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, sipas nenit 59/c të ligjit.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u mbledh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, sipas parashikimit të pikës 5, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, bazuar në germën “a”, të pikës 1, të nenit 58 dhe pikës 1, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

V E N D O S I:

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, znj. Marsela Dervishi, gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier.

2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, i njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë brenda 30 ditëve pas përfundimit të seancës dëgjimore dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim mund të ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga subjektet e interesuara brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

Ky vendim u shpall në Tiranë, në datën 25.3.2021.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Xhensila PINE
Kryesuese

Firdes SHULI
Relatore

Olsi KOMICI
Anëtar

Sekretare gjyqësore
Orianda Liçi